



**KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT
ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE**

**RAPORT MBI SITUATËN E RESPEKTIMIT TË TË
DREJTAVE TË NJERIUT NË SHQIPËRI PER VITIN
2012**

JANAR 2013



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Ky raport është përgatitur në kuadër të projektit “Përmirësimi I situatës të të drejtave të njeriut në Shqipëri nëpërmjet forcimit të shtetit të së drejtës – Klinika ligjore VI”, zbatuar nga Komiteti Shqiptar I Helsinkit (KSHH) dhe mbështetur financiarisht nga Civil Rights Defenders (CRD)



Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi e plotë e Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe nuk reflekton qëndrimin e Civil Rights Defenders.

Përgatitën publikimin: Av. Vjollca Meçaj, Drejtore Ekzekutive
MA. Av. Etilda Saliu Gjonaj, Menaxhere Programi I KSHH
MA. Av. Erida Skendaj, Juriste KSHH

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet pa lejen e autorit

Autor: ©Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Rr. “Gjin Bue Shpata”,
Pall. 5/1, Ap.4, Tirana, Albania
Tel: 04 2233671
Cel: 0692075732
E-mail: office@ahc.org.al;
Web site: www.ahc.org.al



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

HYRJE

Respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në Shqipëri ka qenë dhe mbetet thelbi i misionit të Komitetit Shqiptar të Helsinkit (KShH) në 22 vitet e veprimtarisë së tij. Për këtë qëllim organizata vazhdimisht ka ndërmarrë aktivitete që kanë kontribuar në nxitjen, promovimin dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve; zhvillimin e zgjedhjeve të drejta e të lira; rritjen e transparencës së veprimtarisë të administratës publike dhe mirëfunksionimin e saj; rritjen e aksesit të qytetarëve në procesin gjyqësor, në vendimmarrjen e institucioneve shtetërore dhe pushtetit vendor; konsolidimin e shtetit të së drejtës dhe respektimin e parimit për ndarjen dhe balancimin e pushteteve, si premisa për fuqizimin e shtetit demokratik dhe krijimin e mjedisit të përshtatshëm për gëzimin real të të drejtave; përmirësimin e legjislacionit dhe përfshirjen e standardeve më të mira për garantimin e të drejtave dhe lirive njerëzore, etj. Bazuar në këtë veprimtari KShH e ka bërë tashmë traditë që të hartojë, çdo vit, raportin lidhur me respektimin e të drejtëve të njeriut në vend, si dhe problematikat në këtë drejtim.

Qëllimi i këtij raporti është të informojmë dhe ndërgjegjësojmë mbarë opinionin publik, administratën shtetërore dhe subjektet ndërkombëtare të interesuara, lidhur me situatën e sanksionimit dhe respektimit të të drejtave të njeriut në Shqipëri, për vitin 2012 dhe për të prezantuar sugjerimet tona për përmirësimin në situatës. Gjithashtu, raporti ka për qëllim të informojë publikun lidhur me një pjesë të rëndësishme të punës një vjeçare të KShH-së, të realizuar kryesisht, në kuadër të Projektit “*Për një respektim më të mirë të të drejtave të njeriut nëpërmjet forcimit të shtetit të së drejtës*”¹, i cili është mbështetur financiarisht nga organizata suedeze Civil Rights Defenders (*ish Komiteti Suedez i Helsinkit*.) Për hartimin e raportit janë shqfrytëzuar dhe gjetje të rëndësishme nga veprimtari të zhvilluara gjatë këtij nga Programe e projekte të tjera të KSHH².

Me këtë rast dëshirojmë të shprehim falenderimet e përzemërta për: anëtarët e Asamblesë së KSHH-së, veçanërisht për *znj. Aurela Anastasi, z. Artan Hoxha, z. Sokol Sadushi, z. Arben Puto, z. Jorgo Bulo, z. Kujtim Çashku, Elvis Koçi etj.*, të cilët kanë ofruar konsulencë të çmuar juridike, ose në fusha të tjera, si dhe për informacionet dhe sugjerimet e vlefshme që na kanë dhënë. Falenderojmë monitoruesit që kanë bashkëpunuar me ne, në mënyrë të veçantë *av. Gramoz Çela, av. Znj. Mimoza Preça, znj. Valbona Tahiraj, z. Edis Ibrahim, av. Mirjana Dora, z. Ilir Miti, z. Klodian Gjermani, znj. Arjana Reli etj.* për paanshmërinë, objektivitetin dhe profesionalizmin e tyre; falenderojmë korrespondentët tanë në rrethe *znj. Kaliopi Bici, z. Frederik Jorgaqi, znj. Ketil Qirinxi, z. Klajdi Mone, z. Ymer Leksi, z. Anila Karanxha dhe z. Artan Reçi*, për ndjekjen me përkushtim të çështjeve objekt i këtij raporti dhe informacionet e vlefshme që na kanë dërguar. Gjithashtu një vlerësim i merituar shkon edhe për stafin e organizatës të angazhuar në këtë drejtim.

¹ Ky projekt është zbatuar nga Klinika Ligjore Falas, pjesë e Programit të I-re të KShH-së “*Reforma Ligjore dhe Institucionale, zgjedhje të lira dhe demoraktike, aksesi i qytetarëve në organet e drejtësisë*”

² Programi 2 “*Vëzhgimi i respektimit të të drejtave të njeriut, me fokus personat me liri të kufizuar dhe grupet vulnerabël, si dhe nxitjen e aksesit të qytetarëve praën pushtetit vendor*”, projekte të financuara nga OSI Budapest, UNICEF, CRD etj



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Viti 2012 shënoi rritje të mëtejshme të aktivitetit mbikqyrës të organizatës sonë, me qëllim vlerësimin gjithnjë e më të mirë të situatës së respektimit të të drejtave dhe lirive themelore. Për këtë qëllim janë ndërmarrë monitorime dhe verifikimeve në terren; është ndërhyrë pranë autoriteteve përkatëse, për të mundësuar rivendosjen e të drejtave të shkelura; janë marrë dhe trajtuar ankesa dhe kërkesa konkrete nga shtetas të veçantë; është reaguar publikisht për raste flagrante të cenimit të të drejtave të njeriut; jemi përfshirë në procesin ligjberës, duke ofruar vërejtje e sugjerime, me qëllim përmirësimin e projektligjeve nga pikëpamja e respektimit të të drejtave të njeriut dhe për t'i garantuar më mirë ato; kemi bashkëpunuar me struktura të ndryshme shtetërore, si dhe kemi zhvilluar aktivitete të shumta për rritjen e kapaciteteve profesionale, veçanërisht të strukturave që trajtojnë personat me liri të kufizuar, me qëllim që kësaj kategorie t'u respektohen më mirë të drejtat e sanksionuara në ligj, etj.

Për të vlerësuar situatën dhe për të grumbulluar informacionin e duhur, janë ushtruar monitorime sporadike dhe të planifikuara, duke u përqëndruar veçanërisht në të drejta të rëndësishme si: e drejta për jetën, ndalimi i torturës dhe trajtimit ç'njerëzor e degradues, e drejta për liri dhe siguri, e drejta për barazi në ligj dhe para ligjit, mbrojtja nga diskriminimi, e drejta për një proces të rregullt ligjor, e drejta për të përfutur mbrojtje falas, e drejta për akses pranë organeve të administratës shtetërore dhe qeverisjes vendore³, etj. Vëmendje e veçantë i është kushtuar respektimit të këtyre të drejtave për personat me liri të kufizuar, personave në kushte të vështira sociale e shëndetësore, si dhe pakicave kombëtare e kulturore.

Pas një periudhe të gjatë, KShH, gjatë këtij viti, është angazhuar përsëri për monitorimin e veprimtarisë së organit të Prokurorisë dhe Gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë dhe Durrës, duke u fokusuar në zbatimin e procedurave për mosfillimin ose pushimin e hetimit dhe kundërshtimin e këtyre vendimeve në Gjykatë⁴, si dhe procedurat për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore penale me burgim.

Nga vëzhgimet e kryera konstatuam një sërë arritjesh, veçanërisht në kuadër të sanksionimit më të mirë ligjor të të drejtave dhe lirive të shtetasve. Janë miratuar shumë dispozita ligjore, si dhe janë ratifikuar mjaft akte ndërkombëtare, të cilat kanë ndihmuar në këtë drejtim. Megjithatë, zbatimi i ligjeve dhe akteve ndërkombëtare vazhdon të mbetet problem shqetësues; janë ngritur institucione të reja dhe janë fuqizuar më tej institucionet ekzistuese, që kanë për mision të veprojnë në drejtim të respektimit më të mirë të të drejtave të njeriut, por aktiviteti i tyre mbetet ende i kufizuar; u zgjodh Avokati i Popullit dhe u fuqizua më tej bashkëpunimi i këtij institucioni me shoqërinë civile dhe administratën publike, por shumë rekomandime të tij nuk merren në shqyrtim nga institucionet përkatëse; janë kryer investime në shkolla, spitale, rrugë, burgje, paraburgime dhe komisariate policie, por ende ka nevoja të mëdha në këtë drejtim dhe niveli e shërbimeve që u ofrohet shtetasve nga këto institucione ka nevojë për përmirësime të mëtejshme. Nga vëzhgimet rezulton se përgjithësisht, në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale ofrohet më tepër siguri për të burgosurit dhe të paraburgosurit, veçanërisht në drejtimin fizik. Është ulur numri i incidenteve apo tentativave për vetëvrasje, ose vetëdëmtimeve të personave të privuar nga liria, ka filluar shkollimi për të miturit me liri të kufizuar që nuk e kanë kryer arsimin e detyruar, janë krijuar seksione të veçanta për trajtimin më të mirë

³ Monitorim I kryer në 7 rrethe të vendit

⁴ Gjetjet nga monitorimi dhe studimi i vendimeve/dojesve të Prokurorisë dhe Gjykatës do të gjejnë pasqyrim në një raport të veçantë I cili pritet të publikohet në fillim të vitit 2013



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

të personave me liri të kufizuar, që janë të sëmurë ose me probleme të ndryshme sociale. Konstatohet ndërgjegjësimit dhe ndjeshmëri më e lartë e personelit të burgjeve, paraburgimeve dhe komisariateve të policisë lidhur me respektimin e të drejtave të njeriut, për personat me liri të kufizuar, si dhe është përmirësuar më tej kualifikimi i stafëve që punojnë në këtë sektor. Megjithatë ka ende probleme, mangësi dhe nevoja të mëdha edhe në këtë sektor. Janë kryer hapa të rëndësishëm në decentralizimin e pushtetit vendor, por kjo nuk është shoqëruar me mjetet e duhura financiare dhe teknike për të mundësuar marrjen e rezultateve të pritshme nga ky proces. Megjithë arritjet e mësipërme ende konstatohen shumë cenime të të drejtave njerëzore, të cilat shkaktohen në shumicën e raste nga administrata publike. Shkeljet dhe cenimet më të shumta u përkasin të drejtave si vijon:

Gjatë vitit 2012 shteti nuk ka përbushur si e sa duhet detyrimet e veta në drejtim të garantimit të të drejtës për jetën. Në disa raste persona të ndryshëm kanë humbur jetën ose ju është dëmtuar shëndeti, duke qenë nën kujdesin e organeve shtetërore. Janë kryer një numër i madh krimesh me rrezikshmëri të theksuar shoqërore që kanë sjellë si pasojë dëmtimin e shëndetit dhe humbjen e jetës së shumë shtetasve, të tilla si: vrasje; plagosje të rënda; grabitje me armë; krimet ose dhuna brenda familjes; aksidente të rënda automobilistike; aksidente në punë; sëmundje seksualisht të trasmetueshme; sëmundje që shkaktohen nga ndotja e mjedisit etj. Nuk mund të lëmë pa përmendur edhe rastet e vetëflimit për shkak dëshpërimit të thellë që u është shkaktuar shtetasve nga mos zgjidhja e drejtë ose në kohë, e çështjeve të parashtruara prej tyre përpara autoriteteve shtetërore. Strukturat përgjegjëse të shtetit nuk kanë ndërmarrë studime ose kërkime, për të gjetur shkaqet dhe rrethanat që sjellin këto pasoja, nuk janë marrë gjithmonë masat për të vërë përpara përgjegjësisë personat përgjegjës, si dhe nuk janë marrë masat e nevojshme parandaluese, me qëllim mbrojtjen e të drejtës së jetës dhe hetimin efektiv të rasteve kur kjo e drejtë shkelet, veçanërisht në rastet kur e drejta e jetës është cenuar ose rrezikuar nga veprimet ose mosveprimet e institucioneve shtetërore që i kanë pasur këta persona në kujdesje.

Gjatë vitit 2012, KShH⁵, ka kryer monitorime të planifikuara në 50% të IEVP, në 11 komisariate policie të vendit, si dhe 24 misione sporadike monitorimi, të nxitura nga ankesat e shtetasve me liri të kufizuar. Me gjithë përmirësimet e vërejtura, është konstatuar ende mbipopullim⁶ në disa institucione, i cili u përmirësua disi pas amnistisë të miratuar nga Kuvendi, në kuadër të 100 vjetorit të pavarësisë. Është konstatuar mungesë e stafit mjekësor të specializuar dhe kujdestarëve, mungesë medikamentesh, si dhe cilësi e ulët e shërbimit stomatologjik që u ofrohet personave me liri të kufizuar, në përgjithësi dhe ndaj personave me sëmundje mendore, në veçanti. Gjithashtu situata e personave me masë mjekësore “Mjekim i Detyruar”, vazhdon të mbetet e pandryshuar, megjithëse është ngritur disa herë si shqetësim edhe nga organizmat ndërkombëtare. Këta persona mbahen ende në burg, ndonëse gjykata ka urdhëruar **mjekimin e tyre të detyruar pranë një institucioni shëndetësor të specializuar.**

KShH ka marrë 12 ankesa për dhunë nga persona të sistemuar në institucione penitenciare dhe 10 ankesa nga persona të trajtuar në komisaritet e policisë. Jo gjithmonë kemi mundur të provojmë dhunën e pretenduar, por në shumë raste kemi konstatuar gjurmët e dhunës së ushtruar në trupin e personave me liri të kufizuar. Ndërkohë Avokati i Popullit, mediat dhe organizata të tjera të shoqërisë civile kanë ngritur gjithashtu shqetësime në këtë drejtim, duke pasqyruar edhe raste konkrete dhune të dokumentuar. Shërbimi shëndetësor i institucioneve

⁵ Mbështetur financiarisht nga Civil rights Defenders, nënprogram i Programit të I “Reforma Ligjore dhe Institucionale, zgjedhje të lira dhe demoraktike, aksesit i qytetarëve në organet e drejtësisë (ose ndryshe Klinika ligjore falas)”

⁶ Në IEVP Fushë – Krujë, IEVP Vaqarr dhe IEVP Shën Koll



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

penitenciare nuk u përgjigjet menjëherë kërkesave të të burgosurve/ paraburgosurve për ekzaminim mjekësor kur pretendojnë se janë dhunuar fizikisht, gjë që do të ndihmonte për rikuperimin e shëndetit të tyre, provimin e dhunës, gjetjen e shkaktarëve dhe vënien e tyre para përgjegjësisë.

Nga monitorimet e kryera në polici, janë konstatuar probleme si: ndjekja e praktikave të gabuara lidhur me shoqërimin, ndalimin dhe arrestimin e personave; mospasqyrimin ose pasqyrimin jo të saktë të të dhënave në regjistrat përkatëse për momentin e hyrjes dhe të daljes së një personi të shoqëruar, ndaluar ose arrestuar; mosnjohimin e të drejtave të personave të shoqëruar, ndaluar ose arrestuar; mosnjohimin e familjeve të tyre, etj. Raste flagrante ishin shoqërimet e shpeshta dhe të pamotivuara të ish të përndjekurve politikë nga komisarite të ndryshme të policisë në Tiranë, gjë që u krijon këtyre personave pasiguri dhe cënim të lirisë. Policia e shtetit, gjithashtu, nuk respektoi si duhet ligjin në lidhje me grevën e të përndjekurve politikë, duke i cënuar hapur këtë grupi lirinë e manifestimit.

Minoriteti Rom ka qenë ndër grupet më të diskriminuara të shoqërisë shqiptare. Me keqardhje konstatojmë se organet e qeverisjes nuk kanë marrë masat e nevojshme me qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës së këtij minoriteti, i cili vuan mungesën e strehimit, të infrastrukturës, mungesën e shërbimeve shëndetësore dhe shërbimeve të tjera sociale, mungesën e mundësive për frekuentimin e shkollës ose kopshteve nga fëmijët e tyre, etj.

Gjatë vitit 2012, viktimë e akteve të ndryshme me karakter diskriminues, të kryera në mënyrë direkte ose indirekte, kanë qenë sidomos gratë, fëmijët dhe personat me aftësi të kufizuara, si dhe komuniteti LGBT. Tërheqim vëmendjen në lidhje me diskriminimin e komuniteti të personave me aftësi të kufizuara, të cilin, në disa rrethe, prej muajsh nuk ju paguhen të ardhurat sipas ligjit. Diskriminimi në marrëdhëniet e punës vazhdon të jetë prezent, duke u manifestuar së shumti nëpërmjet largimeve të padrejta nga puna.

KShH, gjatë vitit 2012, ka trajtuar 30 ankesa që i adresohen veprimtarisë gjyqësore dhe janë monitoruar 26 seanca gjyqësore, lidhur me këto ankesa. Nga ky kontakt i drejtëpërdrejtë me proceset gjyqësore është konstatuar se ato fillohen me vonesa të gjata, për shkak të organizimit jo të mirëtë punës dhe mungesës së mbikëqyrjes; seancat shtyhen në afate të gjata kohore; gjykimet zhvillohen me shumë seanca dhe shpesh, në mjedise të vogla që pengojnë aksesin e publikut, etj.

E drejta e pronës ende ndeshet me cënime të shumta. Nuk ka përfunduar procesi i legalizimit të ndërtimeve pa leje dhe kompensimi i ish pronarëve. Kjo situatë shkaktohet nga konfuzioni ligjor, nga zbatimi i gabuar i tij, nga korrupsioni ose inkompetenca e nëpunësve që merren me këto procedura, keqfunksionimi i zyrës së regjistrimit të pasurive të paluejtëshme, si dhe nga vonesat për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

Gjatë vitit 2012, KShH ka marrë ankesa edhe për veprimtarinë e disa institucioneve publike dhe private, si p.sh. shqetësime në lidhje me mënyrat e caktimit dhe të kryerjes së pagesave të ndihmës ekonomike, pensione ose kompesimeve të ndryshme, ndërprerjet kolektive të energjisë elektrike dhe të ujit të pijshëm, pa marrë në konsideratë pagimin e faturave etj. Lidhur me pushtetin vendor është konstatuar se mënyra e trajtimit të ankesave të qytetarëve le për të dëshiruar, se ky pushtet është pajisur me kompetenca të reja nga procesi i decentralizimit, por ky proces nuk është shoqëruar me transferimin e buxhetit të mjaftueshëm për zgjidhjen e



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

çështjeve përkatëse, ose sigurimin e burimeve të nevojshme njerëzore, ose ngritjen e kapaciteteve të tyre.

Në mënyrë më të detajuar, pasqyrimi i problematikës dhe situata e respektimit të të drejtave të njeriut për çështjeve të ndjekura janë paraqitur në këtë raport, duke u grupuar sipas të drejtave themelore, për të cilat KShH ka qenë e angazhuar gjatë këtij viti.

1. E DREJTA E JETËS

E drejta e jetës është një e drejtë themelore që mbrohet nga Kushtetuta dhe aktet ndërkombëtare të zbatueshme në R.SH. Gjatë vitit 2012, ka pasur një numër të lartë të krimeve me rrezikshmëri të theksuar shoqërore, që kanë sjellë si pasojë dëmtimin e shëndetit dhe humbjen e jetës së shumë shtetasve, të tilla si: vrasje, plagosje të rënda, grabitje me armë, krimet ose dhuna brenda familjes, aksidente të rënda automobilistike, aksidente në punë, sëmundje seksualisht të trasmetueshme, sëmundje që shkaktohen nga ndotja e mjedisit, etj. Nuk mund të lëmë pa përmendur edhe rastet e vetëflijimit për shkak dëshpërimit të thellë për moszgjidhjen e drejtë ose në kohë, të problemeve të parashtruara nga viktimat përpara autoriteteve shtetërore. Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë vazhdon të rritet.⁷

Kështu gjatë vitit 2012, ishte flagrante dhe makabre vrasja e 24 grave dhe dëmtimi shumë i rëndë i shëndetit për 4 të tjera, si rezultat i dhunës në familje, ku ndonjë prej tyre ka qenë me urdhër mbrojtje nga gjykata; vdekja e të dënuarit A.R, në IEVP Shën Koll, i cili ishte qëlluar nga një i dënuar tjetër; vrasja në krye të detyrës e shefit të Komisarariatit të Policisë së Shijakut; vrasja e G.B në Elbasan, që ndodhej me masën arrest në shtëpi; më shumë se 11 vrasje për gjakmarrje⁸, midis tyre vrasja e të miturës Marie dhe gjyshit të saj; vrasja e pastorit D.Prroni⁹; vetëflijimi i shtetasës T.O. viktimë e ngjarjes së Gërdecit; rasti i paprecedentë i vetëflijimit e tre grevistëve të urisë, ish të përndjekurve politik, me pasojë vdekjen e njërit prej tyre dhe plagosjen e rëndë të dy të tjerëve, si dhe trajtimi degradues e çnjerëzor i grevistëve nga ana e policisë, duke ju hequr dhe mjetet e fundit të jetesës si ilaçe, kafe, sheqer dhe serume¹⁰; dëmtimi i gjendjes shëndetësore për rreth 26 fëmijë e të moshuar të komunitetit rom për shkak të dëbimit të paligjshëm nga vendbanimi i tyre nga punonjësit e Bashkisë Tiranë, në periudhën janar-shkurt 2012; etj.

Sjellim në vëmendjen tuaj se sipas studimit të IDN-së për situatën e krimit të vrasjes në Ballkanin Perëndimor, Shqipëria zinte vendin e parë për vitin 2011, me shifrën 4 vrasje për 100.000 banorë.

Këto krime të rënda shpesh janë motivuar nga motive të dobta, nga hakmarrja, ose gjakmarrja, ose nga mosmarrëveshjet brenda familjes, por KShH ka vënë re edhe një numër gjithnjë në rritje të aksidenteve rrugore, raportime të shumta të aksidenteve në punë, veçanërisht në sektorin e minierave dhe të ndërtimit, vdekje në kurim e sipër pranë institucioneve shëndetësore që janë shoqëruar me pretendimin e pakujdesisë së personelit mjekësor. Ka, gjithashtu, një numër në rritje të personave të zhdukur dhe ende të pagjetur nga organet përkatëse. KShH ka konstatuar

⁷ Raporti vjetor i Prokurorisë së Përgjithshme 2011, në vitin 2010, koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë ka qenë 529 dhe në vitin 2011 është rritur në 695.12, vrasjet me paramendim janë rritur 24% në vitin 2011 në krahasim me 2010

⁸ Gazeta Shqip 13 shtator 2012- vetem në Dukagjin e Puke 11 të vrare për gjakmarrje gjatë këtij viti

⁹ Qe nga viti 1998 janë vrare 2.600, prej të cilëve 225 për gjakmarrje (Gazeta IDEA në referim të konferencës në Shkoder për këtë fenomen).

¹⁰ Shih denoncimin e Avokatit të Popullit në Prokurori



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

raste sporadike, por tepër shqetësuese, të humbjes së jetës së personave, që kanë qenë nën mbikqyrjen e policisë dhe autoriteteve shtetërore, si rasti i G.B i cili u vra me armë zjarri, më 15 Gusht 2012, në qytetin e Elbasanit, ndërkohë që ndodhej në arrest shtëpie dhe ruhej nga punonjës të policisë së shtetit. Në datën 21 Gusht 2012, duke marrë shkas nga incidenti i rëndë në IEVP Shën Koll, ku mbeti i vrarë i dënuari A.R, i cili ishte qëlluar në ambientet e ajrimit, me mjete të forta nga një i dënuar tjetër, si dhe pas verifikimit të një ankese tjetër, dërguar nga një i dënuar në të njëjtin institucion, i cili pretendonte se ishte dhunuar nga bashkëvuajtësit e dënimit, KShH i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve me anë të një letre, nëpërmjet së cilës ngrinim shqetësimin e sigurisë në këtë institucion dhe sugjeruam marrjen e masave të menjëhershme për përmirësimin e situatës. Një ngjarje e rëndë, që tronditi mbarë opinionin publik, ishte vrasja në krye të detyrës, më 13 Shtator, e shefit të Komisarariatit të Policisë së Shijakut, të ndjerit Adem Tahiraj.

Lidhur me këto raste, Gjykata Evropiane e të Drejtave të njeriut ka interpretuar në jurisprudencën e saj se *“Personat që janë nën mbikqyrjen e organeve të policisë/burgjeve, kanë një pozitë vulnerabël dhe autoritetet kanë detyrimin të përgjigjen për trajtimin e tyre. Rrjedhimisht, kur një person i cili merret në mbikqyrje në gjendje të mirë shëndetësore dhe më pas vdes, është detyrë e shtetit të japë shpjegime për rrethanat që kanë çuar në vdekjen e tij. (shih çështjen Ognyanova dhe Choban k.Bullgarisë, parag.94)”*.

Gjatë vitit 2012 kanë ndodhur një numër jo i vogël vetëvrasjesh, ose tentativa me këtë qëllim, të motivuara nga shkaqe social-ekonomike. Rast tepër flagrant dhe i paprecedentë që tërhoqi vëmendjen e mbarë opinionit publik, brenda dhe jashtë vendit, ishte tentativa për vetëflim e tre grevistëve të urisë, ish të burgosur politikë, të cilët i vunë flakën vehtes, në shenjë proteste ndaj shurdhërisë së organeve kompetente shtetërore, të cilët nuk kishin pranuar të takoheshin me këtë komunitet dhe të dialogonin për probleme të natyrës ekonomike që i shqetësonin ata. Për shkak të plagëve të rënda të shkaktuara nga djegia, një prej ish të burgosurve politikë humbi jetën në spital, ku po kurohej. Gjithashtu përmendim, urdhërin e autoriteteve të Bashkisë Tiranë për prishjen me forcë, në mes të dimrit, të banesave të improvizuara (brakave) të disa familjeve rome dhe lënia e tyre pa strehë që shkaktoi dëmtimin e shëndetit të këtyre banorëve, midis tyre dhe 26 fëmijëve e të moshuarve.

KShH ka reaguar publikisht në 10 raste gjatë vitit 2012¹¹, nëpërmjet deklaratave për shtyp dhe intervistave të dhëna në mediat e shkruara dhe ato vizuale, sidomos në rastet ku ka evidentuar që e drejta e jetës është cenuar ose rrezikuar nga veprimet ose mosveprimet e institucioneve shtetërore që i kanë pasur këta persona në kujdesje, si dhe në rastet kur shtetasit kanë pësuar dëmtime të shëndetit ose kanë humbur jetën si pasojë e veprimeve të kundraligjshme, tepër flagrante, që mund të ishin parandaluar, nëse autoritetet shtetërore do të mbikëqyrnin më mirë rrugët, institucionet e shërbimit shëndetësor, rregullat e sigurimit në punë, cilësinë e mjedisit, ose nëse do të kishin kryer studime rreth problemeve sociale që ka shoqëria jonë dhe do të kishin marrë masa për t'i zgjidhur, ose lehtësuar ato etj. KShH është i mendimit se një pjesë e këtyre vdekjeve ose dëmtime të shëndetit i bashkon fakti se mund të ishin parandaluar nëse shteti do të përmbushte më mirë detyrimet e tij pozitive, e negative, që i burojnë nga sanksionimi kushtetues dhe konventor, për të drejtën e jetës.

Për këto arsye vazhdojmë t'i bëjmë thirrje shtetit, që jo vetëm të sanksionojë më mirë të drejtën për jetën, por edhe të ndërmarrë studime në këtë drejtim, për të gjetur shkaqet dhe rrethanat që

¹¹ Shih deklaratat për shtyp të KSHH në www.ahc.org.al



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

sjellin këto pasoja të rënda, të marrë masa për t'i shmangur ato, të vërë përpara përgjegjësisë penale personat përgjegjës, nëpërmjet hetimit të paanshëm dhe efektiv, si dhe të shtojë masat parandaluese, me qëllim mbrojtjen e të drejtës së jetës.

2. RESPEKTIMI I TË DREJTAVE TË PERSONAVE TË PRIVUAR NGA LIRIA DHE E DREJTA PËR TË MOS IU NËNSHTRUAR TRAJTIMIT Ç'NJERËZOR DHE DEGRADUES DHE TORTURËS

E drejta për të mos iu nënshtuar torturës, trajtimit ç'njerëzor dhe degradues është sanksionuar në nenin 25 të Kushtetutës dhe në nenin 3 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ). Kjo është një e drejtë që ka karakter absolut dhe rrjedhimisht kufizimi apo cënimi i saj nuk mund të justifikohet në asnjë rrethanë. Sipas Kodit tonë Penal, tortura dhe çdo veprim tjetër që shkakton vuajtje të rënda, fizike apo mendore parashikohet si vepër penale dhe dënohet deri në 10 vjet burg, ndërsa kur ka pasoja të rënda dënohet deri në 20 vjet burg. Nga jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), rezulton se personat e privuar nga liria në komisarate policie, në burgje dhe paraburgim, janë më të ekspozuar për të qenë viktimë e torturës, trajtimit ç'njerëzor dhe degradues. GjEDNj ka vlerësuar në vendimin *Kudla kundër Polonisë*¹² se **“Shteti duhet të sigurojë që personi të privohet nga liria të jetojnë në kushte të cilat janë të përshtatshme, në respekt të dinjitetit të tij njerëzor, se mënyra dhe metoda për ekzekutimin e masës së sigurisë/dënimin të tij nuk do t'i shkaktojnë atij ankth dhe vuajtje të një intensiteti të tillë që kalon nivelin e pashmangshëm të vuajtjes që është pjesë e pandashme e ambientit të mbyllur”**.

KSHH, ka patur ndër vite në fokus të vazhdueshëm promovimin dhe respektimin e të drejtave të personave të privuar nga liria. Gjatë vitit 2012, në kuadër të veprimtarisë së vet¹³, KSHH ka kryer monitorime të planifikuara në 50% të IEVP, në 11 komisarate policie të vendit, si dhe 18 monitorime sporadike në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) dhe 6 monitorime sporadike në Komisaritet e Policisë. Këto monitorime kanë patur në fokus vëzhgimin e kushteve të jetesës së personave të privuar nga liria dhe respektimin e të drejtave të tyre nga stafi i institucionit, verifikimin e ankesave të ardhura në adresë të KSHH-së¹⁴, ofrimin e shërbimeve ligjore falas; etj.

Lidhur me ankesat e personave të privuar nga liria, informojmë se janë trajtuar 103 ankesa/kërkesa nga personat e privuar nga liria në burgje/paraburgim dhe 17 ankesa/kërkesa nga personat e privuar nga liria, ose qytetarë të lirë, që kanë ngritur probleme në lidhje me organet e policisë¹⁵. Nga 18 monitorimet që janë kryer në IEVP, 5 prej tyre kanë qenë monitorime tematike që janë kryer në Institutin e Veçantë të Zaharisë dhe në Qendrën Spitalore të Burgjeve. Monitorimet tematike kanë patur si objekt kryesor, trajtimin e të dënuarve, në kushte të veçanta, atyre të sëmurë dhe të personave me masë mjekësore “Mjekim i detyruar” ose “Shtrim i Përkohshëm në një Institucion Psikiatrik”.

Aksesi për vëzhguesit tanë në monitorimin e Institucioneve të Ekzekutimit të Vendimeve Penale dhe në Komisaritet e Policisë ka qenë i mirë. Monitorimet në IEVP bëhen në kuadër të një marrëveshje që KSHH ka me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve ndërkohë që monitorimet në

¹² *Kudla k. Polonisë* (Aplikimi nr. 30210/96, Vendimi dt.26 Tetor 2000)

¹³ Mbështetur financiarisht nga Civil rights Defenders, nënprogram i Programit të I “Reforma Ligjore dhe Institucionale, zgjedhje të lira dhe demoraktike, aksesi i qytetarëve në organet e drejtësisë (nënprogram Klinika ligjore falas)”

¹⁴ Ankesat dhe kërkesat janë adresuar në KSHH nëpërmjet telefonit, letrave, medias ose nga takimet e zhvilluara në zyrë me familjarët e të dënuarve/paraburgosurve

¹⁵ Për më shumë informacion shih Aneksin I të këtij raporti, si dhe raportet e punës të pasqyruara në faqen elektronike të KSHH



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Komisariatet e Policisë bëhen në kuadër të lejeve provizore që Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ka akorduar për vëzhguesit e KShH-së. Procesi i lidhjes së marrëveshjes vjetore për monitorim e bashkëpunim me Policinë e Shtetit është pezulluar për shkaqe të paqarta. Pavarësisht praktikave të mira të bashkëpunimit për sa i takon aksesit të vëzhguesve të KShH-së për kryerjen e monitorimeve, gjatë vitit 2012 ka patur raste sporadike ku vëzhguesit e KShH-së janë penguar ose u është kufizuar aksesit nga stafi i institucioneve të monitoruara¹⁶.

▪ **Mbipopullimi**

Nga monitorimet dhe verifikimet e kryera në disa nga institucionet e vuajtjes së dënimit dhe paraburgimit është vërejtur mbipopullim, konkretisht në IEVP Fushë – Krujë, IEVP Vaqarr dhe IEVP Shën Koll¹⁷. Ka patur raste, kur mbipopullimi ka ndikuar negativisht në plotësimin e kushteve të jetesës, të parashikuara në ligj. KShH vëren se, megjithëse ligji nr.10494, datë 22.12.2011 “*Për Mbikqyrjen Elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor*” ka hyrë në fuqi në datën 1 Prill 2012, ende nuk janë marrë të gjitha masat e nevojshme për zbatimin e tij, si dhe nuk janë përgatitur aktet nënligjore të nevojshme ose planifikimi i buxhetit për këtë qëllim. Neni 20, paragrafi 1 i ligjit parashikon se “*Ligji, menjëherë pas hyrjes në fuqi, fillon të zbatohet ndaj subjekteve të parashikuara nga neni 4 i këtij ligji, gjykimi i të cilave është në kompetencë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor dhe Gjykatës së Apelit Tiranë, të cilat urdhërojnë përdorimin e MESë, pas informimit nga Shërbimi i Provës për mundësitë teknike të realizimit të saj.*” KShH vlerëson se, zbatimi i këtij ligji do të ndihmonte veçanërisht në uljen e mbipopullimit në sektorët e paraburgimit, por dhe në sektorët e të dënuarve, për shkak se ligji aplikohet edhe për mbikqyrjen e alternativave të dënimit me burgim. Amnistia e miratuar nga Kuvendi, në kuadër të 100 vjetorit të pavarësisë së vendit, lehtësoi disi situatën e rënduar, megjithatë është e nevojshme që në kuadër të mbipopullimit të këtyre institucioneve të ndërmerren studime dhe të përcaktohen rrugë dhe mjete institucionale, organizative dhe ligjore, që do të shërbejnë për të përmirësuar situatën në vazhdimësi.

▪ **Shërbimi Shëndetësor**

Monitorimet në Institutin e Veçantë të Zaharisë dhe në Qendrën Spitalore të Burgjeve (QSB), por edhe më gjerë, kanë patur në fokus parësor kushtet dhe cilësinë e shërbimeve shëndetësore, që u ofrohej personave të privuar nga liria. Një ndër problematikat e konstatuara në këto dy institucione, ku mjekohen të dënuarit e diagnostikuar me probleme të ndryshme shëndetësore, është mungesa e stafit mjekësor të specializuar. Kështu, në Institutin e Zaharisë Krujë ndodheshin 97 të sëmurë mendorë, ndërkohe që në këtë institucion punonte vetëm një mjek psikiatër. Në organikën e stafit mjekësor të këtij institucioni është parashikuar të punojnë dy mjekë psikiatër, por njëri vend është ende vakant për shkak të mungesës së aplikimeve nga mjekë të këtij specializimi. Në QSB ka vetëm një mjekë psikiatër, e cila ofron shërbim edhe për institucione të tjera në Tiranë, Durrës e Krujë, për shkak të mungesës së specialistëve të fushës¹⁸. Në QSB, mungon në organikë mjeku kardiolog dhe përkohësisht shërbimet mjekësore të këtij specialisti i ofronte mjeku kardiolog i Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, por me kohë të pjesshme. Në QSB, u vu re edhe numër i ulët i kujdestarëve që duhet të kujdesen

¹⁶ Në datën 9 Maj 2012, dy vëzhgues të KShH-së u penguan të monitoronin IEVP Vaqarr nga drejtori i këtij institucioni; në datën 7 Dhjetor 2012, dy vëzhgues të KShH-së u penguan të monitoronin Komisariatin e Policisë nr.3 në Tiranë nga shefi i këtij komisarati;

¹⁷ Respektivisht monitorimet e dt. 7 Maj, 26 Qershor dhe 22 Nëntor 2012;

¹⁸ KShH, 2012, Raporti “*Mbi situatën e të drejtave të njeriut për personat e privuar nga liria në institucionet e paraburgimit dhe ekzekutimit të vendimeve penale*”



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

dhe të ndihmojnë në mbajtjen e higjienës personale të sëmurëve mendorë dhe për ata me aftësi të kufizuar fizike. Jemi të mendimit se niveli i ulët i pagave për stafin e lartë mjekësor të specializuar, atij me arsim të mesëm dhe stafit sanitar që shërbejnë në këto institucione dhe që kanë shkallë të lartë vështirësie në punë, ndikon në mos aplikimin e kandidatëve për t'u punësuar në këto vende pune, gjë që na u konfirmua edhe nga drejtuesit e institucioneve.

Për sa i takon furnizimit të institucioneve penitenciare me medikamente janë konstatuar probleme në IEVP-në Peqin, IP Durrës dhe IEVP Shën Koll¹⁹, etj. Nga kontaktet e monitoruesve të KSHH-së me të dënuarit dhe të paraburgosurit në këto institucione, u morrën ankesa për mungesën e medikamenteve, duke përfshirë dhe mungesën e atyre medikamenteve që përdoren për të sëmurët kronikë²⁰.

Bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.337, datë 06/04/2011, dhe në udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë, nënshkruar në dt. 24 Maj të 2012, “*Mbi përfshirjen e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve në skemën e sigurimeve shëndetësore të detyrueshme*”, në disa institucione, si në Shën Koll Lezhë, Fushë Krujë, Zahari Krujë, ka filluar pajisja e të dënuarve me libreza shëndetësore. KShH për vite me radhë ka dhënë rekomandime për një proces të tillë. Megjithatë theksojmë se stafi mjekësor i këtyre institucioneve është ende i paqartë për zbatimin e procedurave të përfshirjes në skemë të personave me liri të kufizuar, për shkak të mungesës së trajnimeve nga ana e Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor. Për këtë arsye do të rekomandonim ISKSH-së të përgatisë udhëzime të mirë detajuara, për zbatimin e këtij VKM-je, në ndihmë të stafit mjekësor të Institucioneve të mbyllura, si dhe të trajnojnë stafin përkatës të burgjeve dhe paraburgimit për zbatimin me korrektësi të VKM-së dhe akteve të tjera që veprojnë në këtë fushë.

Një problem tjetër i konstatuar në QSB, i cili ka për detyrë të ofrojë shërbime shëndetësore dhe të mundësojë kurimin e të dënuarve të diagnostikuar me sëmundje të ndryshme, është se në këtë institucion nuk mund të kryhen ekzaminime mjekësore, për shkak të mungesës së pajisjeve dhe mjeteve. Të gjitha ekzaminimet, ndërhyrjet kirurgjikale ose të mikrokirurgjisë kryehen në Spitalet Civile të QSUT-së. KShH konstatoi se për shkak të mbingarkesës në spitalin civil, ndërhyrjet për të dënuarit e QSB-së shtyeshin ose kryeshin me vonesë, sepse spitali publik u japin përparësi pacientëve të tyre. Për shkak të larmishmërisë së sëmundjeve nga të cilat vuajnë të dënuarit që akomodohen në QSB, vlerësojmë se ky institucion duhet fuqizuar më tej me mjekë të specialiteteve të ndryshme.

Nga databaza e ankesave të Klinikës Ligjore të KSHH-së, rezulton se gjatë vitit 2012, janë trajtuar 21 ankesa, marrë nga personat e privuar nga liria në Institucionet Penitenciare, lidhur me çështje të shërbimit shëndetësor. Këto ankesa kanë të bëjnë me mosfrimin e shërbimit shëndetësor në mënyrë periodike dhe të rregullt, moslejimin e të dënuarve për t'u ekzaminuar në spitale private, qoftë dhe me mjetet e tyre financiare, mosdiagnotikimin e saktë të sëmundjeve nga stafi shëndetësor i institucionit, kërkesa për transferim në Qendrën Spitalore të Burgjeve, etj. Lidhur me këto ankesa, kur është gjykuar e arsyeshme, KShH i është drejtuar IEVP dhe/ose Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (DPB) për marrjen e masave dhe zgjidhjen e kërkesës.

▪ **Masa mjekësore “Mjekim i detyrueshëm në një institucion psikiatrik”**

¹⁹ Monitorimi i dt.22 Nëntor 2012

²⁰ Në këtë institucion u takua një person, të cilit i kishin mbaruar ilaçet e tensionit prej 5 ditësh, ilaçe që duhej t'i merrte rregullisht çdo ditë.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Prej disa vitesh, KShH ka konsideruar si të paligjshëm vendosjen dhe mbajtjen në institucionet penitenciare të personave të sëmurë mendorë për të cilët gjykata ka vendosur masën mjekësore “Mjekim i Detyruar në një Institucion Mjekësor”. Personat në fjalë nuk janë të dënuar dhe gjykata, për shkak të papërgjegjshmërisë së tyre mendore në kohën e kryerjes së veprës penale, ka pushuar çështjen penale në ngarkim të tyre dhe ka urdhëruar mjekimin e detyruar **në një institucion të specializuar mjekësor**. Në të njëjtën situatë ndodhen edhe personat me masë shtrënguese “Shtrim i përkohshëm në një Spital Psikiatrik”²¹, të cilët për shkak të mungesës së një institucioni mjekësor të specializuar mbahen gjithashtu në institucione të sistemit penitenciar, ndonëse nuk janë të dënuar dhe nuk duhet të vuajnë ndonjë dënim.

Lidhur me këtë çështje, KShH ka reaguar në forma të ndryshme si p.sh. me anë të raporteve periodike, të cilat janë bërë prezent përpara autoriteteve përkatëse dhe në media, ka sensibilizuar opinionin nëpërmjet intervistave të dhëna në median e shkruar dhe atë elektronike, u është drejtuar me anë të letrave zyrtare institucioneve përgjegjëse si dhe ka diskutuar rreth problemit në tryeza dhe konferenca kombëtare e ndërkombëtare që janë zhvilluar lidhur me të drejtat e personave të privuar nga liria.

Gjatë 2012-ës, KShH ka konstatuar se në Institutin e veçantë të Zaharisë Krujë, rreth 64% e pacientëve janë persona me masë mjekësore “Mjekim i detyruar në një Institucion Mjekësor” ndërkohë që në Qendrën Spitalore të Burgjeve kjo kategori, së bashku me personat me masë sigurimi “Shtrim i përkohshëm në një Spital Psikiatrik”, përbën 52% të pacientëve. Instituti i veçantë i Zaharisë Krujë ashtu si dhe QSB janë institucione penitenciare, ku përkatësisht, në të parin vendosen personat e dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë dhe kategoria e personave të moshuar, ndërsa QSB është institucioni që shërben për të kuruar të dënuarit e diagnostikuar me sëmundje të ndryshme. Pra këto dy institucione nuk janë institucione shëndetësore psikiatrike, në të cilat mund të akomodohen e të kurohen kjo kategori personash. Për këto arsye mendojmë se kjo është një praktikë e gabuar dhe e paligjshme, e cila jo vetëm cenon këtë kategori personash nga e drejta për të patur një trajtim mjekësor të specializuar, i diskriminon ata në raport me personat e tjerë që vuajnë nga të njëjtat sëmundje dhe që kurohen në spitale të specializuara, por gjithashtu, pakëson mundësinë e përdorimit të institucioneve penitenciare në fjalë nga personat me liri të kufizuar dhe rrit mbipopullimin e tyre.

KShH vlerëson se vendosja në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale, të personave me masë mjekësore “Mjekim i detyruar në një institucion mjekësor” dhe i personave me masë sigurimi “Shtrim i Përkohshëm në një Spital Psikiatrik” vjen në kundërshtim me nenin 27 të Kushtetutës dhe nenin 5 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, të cilat parashikojnë në mënyrë eksplicite dhe shteruese rastet se kur mund të kufizohet liria e një personi, por edhe me përcaktimet e ligjit “Për shëndetin mendor” miratuar vitet e fundit nga Kuvendi i Shqipërisë.

▪ *Trajtimi Human*

Gjatë vitit 2012, KShH ka marrë 12 ankesa nga personat e privuar nga liria në IEVP, të cilët kanë pretenduar ushtrim të dhunës fizike apo psikologjike nga personeli i institucionit ose nga të dënuarit e tjerë. Në disa raste, KShH ka kryer monitorime sporadike për verifikimin e këtyre

²¹ Neni 239 i Kodit të Procedurës Penale parashikon se “Kur personi që duhet arrestuar është i sëmurë mendërisht dhe për këtë shkak përjashtohet ose pakësohet shumë zotësia e të kuptuarit ose e vullnetit, gjykata në vend të paraburgimit mund të urdhërojë shtrimin e përkohshëm në një institucion psikiatrik, duke caktuar masat e nevojshme për të parandaluar rrezikun e ikjes”.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

ankesave në institucionet penitenciare, për disa prej tyre ofrojmë një informacion më të detajuar sa më poshtë:

Në datën 8 Mars 2012, u krye një monitorim sporadik në Institucionin e të Miturve në Kavajë. Disa nga të miturit e kontaktuar në këtë institucion pretenduan se keqtrajtoheshin fizikisht dhe verbalisht nga stafi me uniformë i institucionit. Gjithashtu, në këtë institucion u kontaktuan dy të mitur, që gjendeshin në dhomat e veçimit, të cilët ndryshe nga sa parashikon neni 51 dhe 52 i Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve, qëndronin prej 8-9 ditësh në këto ambiente, pa masë disiplinore. Stafi i institucionit nuk ishte në gjendje të na provonte me dokumentacionin përkatës dhënien e masave, kur ne e kërkuam atë. Lidhur me këtë rast, KShH ka vënë në dijeni DPB-në me shkresë zyrtare²². Për sa i takon mbajtjes së të miturve në sektorin e veçimit, DPB na sqaroi zyrtarisht se për një prej tyre ishte mbledhur Komisioni Disiplinor por nuk na sqaruan nëse për të miturin/t janë dhënë masa disiplinore nga Komisioni.

Në dt. 9 Maj 2012, në IEVP Fushë – Krujë, u krye një monitorim sporadik për verifikimin e ankesës së një të dënuari, i cili pretendonte se kishte tentuar të vriste veten për shkak se nuk i merrej parasysh kërkesa për transferim në një institucion tjetër. Nga verifikimi rezultoi se personi ishte neutralizuar në momente të axhitimit, nga stafi i institucionit, nëpërmjet përdorimit të prangave. Lidhur me këtë rast, KShH vuri në dijeni DPB duke theksuar se përdorimi ndaj pacientëve të axhituar, ose që tentojnë të vetvriten i prangave në krevatet e tyre, është konsideruar nga Komiteti për Parandalimin e Torturës (KPT), i barazvlefshëm me trajtimin ç'njerëzor dhe degradues dhe u ka rekomanduar autoriteteve shqiptare t'i japin fund kësaj praktike. Në përgjigjen e saj të dt.02.07.2012, DPB sqaron se i dënuari është kategorizuar si person me ç'rregullime të përshtatjes, agresivitet verbal ndaj të tjerëve, etj, por nuk na jepën sqarime për arsyet e përdorimit të prangave ndaj këtij personi dhe masat e mara.

Në dt.26 Qershor 2012, KShH kreu një mision verifikimi në IEVP Vaqarr, lidhur me ankesën e ardhur në rrugë telefonike nga një i dënuar në këtë institucion. Ai pretendonte se ishte dhunuar verbalisht dhe fizikisht, me shkop gome, nga stafi me uniformë i regjimit të brendshëm të këtij institucioni, për shkak të një debati që kishte lindur lidhur me volumin e lartë të televizorit të dhomës. Nga kqyrja fizike e personit u konstatuan të enjtura dhe hematoma, në gishtat e këmbëve, në kyçin e këmbës së majtë dhe në gjurin e këmbës së djathtë. Gjithashtu, u vërejtën hematoma në pjesën e kurrizit. Për shkak të mungesës së mjekut të institucionit në momentin e vëzhgimit, vëzhguesit e KShH-së nuk patën akses në kartelat mjekësore në të cilat, sipas rekomandimeve të KPT-së, duhet të evidentoheshin pretendimet e të dënuarit për ushtrim dhune, si dhe konstatimet objektive mjekësore pas kryerjes së një ekzaminimi të plotë. Lidhur me këtë monitorim, KShH vuri në dijeni DPB-në, Avokatin e Popullit, Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm në Sistemin e Burgjeve dhe Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në dt.18.07.2012, Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm në Sistemin e Burgjeve, me anë të një shkresë zyrtare falenderon KShH-në, duke na informuar për marrjen e masave për verifikimin e ankesës. Nga ana e saj DPB, në shkresën e saj të datës 01.08.2012, informoi se nga verifikimi i kryer prej tyre nuk ishte vërtetuar që ndaj personit ankues të ishte ushtruar dhunë fizike.

Në dt. 11 Korrik 2012, KShH kreu një mision monitorimi në IEVP Shën Koll, për verifikimin, ndër të tjera, të ankesës së një të dënuari që ishte dhunuar fizikisht nga një i dënuar tjetër. Nga verifikimi u konstatuan në trupin e të dënuarit shenja prerjeje, në duar dhe në kurriz. I dënuari pretendonte se ishte vizituar 12 orë pas dhunimit dhe se ilaçet i kishte blerë me lekët e tij.

²² Shkresa e dt.18/04/2012



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Lidhur me këtë rast, KShH vuri në dijeni Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, e cila nuk ka kthyer përgjigje.

▪ *Ambjentet e veçimit dhe të observimit në Institucione*

Një problematikë tjetër e evidentuar nga monitorimet sporadike të kryera nga KShH ka qenë mbajtja e të dënuarve në dhomat e veçimit, pa masa disiplinore. Kjo praktikë që vjen në kundërshtim me legjislacionin penitenciar, është konstatuar masivisht në të gjitha monitorimet sporadike dhe të planifikuara që kemi kryer në IEVP Shën Koll, IEVP Rrogozhinë, Peqin dhe Institucionin për të Miturit në Kavajë etj. Administrata e institucioneve të monitoruara ka justifikuar përdorimin e kësaj praktike për shkak të problemeve që këta të dënuar kanë me përshtatjen dhe konfliktet me të dënuarit e tjerë, problemet e hasmërisë, ose sepse, sipas tyre, vetë të dënuarit kishin kërkuar të qëndronin në këto ambiente, të veçuar nga të dënuarit e tjerë. KShH ka konstatuar se kjo kategori personash, pavarësisht nga motivet për të cilin ndodhen në izolim, i nënshtrohet pothuajse të njëjtave kufizime si personat e veçuar ndaj të cilëve janë dhënë masa disiplinore, *si psh kufizim për pjesëmarrje në aktivitetet e përbashkëta, ajrim me kohë të kufizuar, privimi nga informimi me mjetet e shtypit të shkruar dhe elektronik etj.* Nga verifikimet rezultoi se në IEVP Shën Koll dhe Peqin, kishte persona që qëndronin mbi 1 muaj në ambientet e izolimit. Në ambientet e observimit dhe të veçimit në IEVP Shën Koll, është konstatuar gjithashtu mbipopullim dhe se në disa nga dhomat, për shkak të mungesës së shtretërve dhe karrigeve/tavolinave personat flinin dhe hanin në tokë.

Lidhur me këtë problematikë, KShH, duke vlerësuar si shumë të rëndësishëm në ekzekutimin e dënimit me burgim në respektim të dinjitetit njerëzor dhe shoqërimin e trajtimit me ndjenja njerëzore, në përputhje me parimet e sanksionuara në aktet ndërkombëtare dhe ligjin “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i është drejtuar disa herë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve me shkresa zyrtare për shkeljet e konstatuara. Në këto shkresa, KShH i ka rekomanduar DPB-së, gjetjen e një zgjidhje konform legjislacionit në fuqi dhe në rast se është e nevojshme, ndryshimin e legjislacionit, me qëllim që kategorisë së personave me liri të kufizuar t’i ofrohen të gjitha garancitë ligjore që mundësojnë respektimin e të drejtave të tyre. DPB, lidhur me këtë çështje, nuk na ka dhënë informacion për rastet e referuara lidhur me këtë problematikë dhe për masat që planifikon të marrë.

Gjatë vitit 2012, KShH ka marrë 10 ankesa nga personat e privuar nga liria në Komisaritet e Policisë, të cilët kanë pretenduar ushtrim të dhunës fizike apo psikologjike, të ushtruar nga stafi me uniformë. Në disa raste, KShH ka kryer verifikimin e këtyre ankesave pranë në Drejtorive të Policisë së Qarqeve dhe/ose Komisaritet e Policisë.

Në dt. 16 Prill 2012, KShH dhe Institucioni i Avokatit të Popullit, ngriti një grup pune²³ për verifikimin e një ngjarjeje të ndodhur në qytetin e Vlorës, lidhur me veprimet e forcave speciale të policisë, të cilët pretendojnë se të maskuar, të armatosur dhe në mënyrë tepër të dhunshme, kishin ndaluar disa të rinj të akuzuar për një sërë grabitjesh. Grupi i verifikimit morri takime të ndryshme me përfaqësues të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, Institucionit të Paraburgimit Vlorë dhe të Drejtorisë së Policisë së Qarkut Vlorë. Gjithashtu u intervistuan 5 shtetasit e arrestuar, të cilët ishin transferuar nga ambientet e Drejtorisë së Policisë së Qarkut Vlorë në ambientet e Institucionit të Paraburgimit Vlorë. Të

²³ në kuadër të zbatimit të marrveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Institucionit të Avokatit të Popullit dhe Komitetit Shqiptar të Helsinkit



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

pesë të arrestuarit pretenduan për keqtrajtim fizik dhe psikologjik, gjatë ndalimit të tyre nga policia, gjatë qëndrimit në ambientet e policisë, si dhe gjatë procesit të marrjes në pyetje nga punonjësit me uniformë dhe civilë të policisë. Ata pretendonin se duke qënë të lidhur me pranga, ishin lënë në dyshemenë e korridorit të godinës së policisë, në pozicion përmbys me fytyrë nga dyshemeja deri në 3-4 orë dhe ishin goditur me shqelma, shkopinj gome, grushta e pëllëmbë, në pjesë të ndryshme të trupit. Megjithëse kishte kaluar një javë nga keqtrajtimi i bërë, tek dy prej tyre u konstatuan shenjat e dhunës si hematoma e dërmishje në duar, në kërcirin e këmbëve dhe në pjesët e kofshëve. Lidhur me këtë ngjarje, Avokati i Popullit i rekomandoi Prokurorisë së rrethit gjyqësor Vlorë fillimin e ndjekjes penale në ngarkim të punonjësve të policisë së forcave operationale të Drejtorisë së Përgjithsme të Policisë së Shtetit, të FNSH-së Fier dhe të Drejtorisë së Policisë së Qarkut Vlorë, të cilët kanë marrë pjesë dhe kanë kryer veprime policore e procedurale me të arrestuarit, për veprën penale të “Torturës” e kryer në bashkëpunim.

Gjithashtu, në dt. 13 Shtator 2012, KShH ka marrë një ankesë nga një i paraburgosur i cili pretendonte se, gjatë qëndrimit në ambientet e Komisarariatit të Policisë së Velipojës, është goditur në mënyrë ç’njerezore nga efektivat e policisë. Për këtë arsye, KShH ju drejtua me shkresë zyrtare, Institucionit të Avokatit të Popullit dhe Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm për kryerjen e verifikimeve përkatëse dhe zbardhjen e kësaj ankese. Ende nuk është marrë një përgjigje nga të dy institucionet për sa i takon kësaj ankese.

Në dt. 28 Shtator 2012, KShH kreu një vëzhgim sporadik në Komisariatin e Policisë nr.6 dhe në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë. Ky verifikim u realizua pas sinjalizimit të KShH-së nga një gazetarë, sipas së cilës një shtetas ishte keqtrajtuar nga shefi i Komisarariatit të Policisë nr.6, në një ambient publik, teksa po punonte në biznesin e tij. Nga verifikimi rezultoi se personi kishte statusin e të ndaluarit. Ai pretendoi se shefi i komisarariatit e kishte goditur me duar dhe me shqelma. Personit iu konstantuan shenja mavijosjeje në fytyrë. Lidhur me këtë ngjarje, paralelisht ishte investuar edhe Avokati i Popullit, i cili pas verifikimeve i kishte rekomanduar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë fillimin e ndjekjes penale ndaj shefit të komisarariatit të policisë.

Në dt. 26 Nëntor 2012, u ngrit një grup monitorimi me përfaqësues të Institucionit të Avokatit të Popullit dhe KShH-së, për verifikimin e rastit të publikuar në media dhe në internet me anë të një videoje, ku rezultonte se një i mitur ishte dhunuar në mënyrë brutale nga policia e shtetit pasi kishte tentuar të merrte një flamur nga rruga. Grupi i punës kreu verifikime dhe intervistoi efektivat e policisë që kishin ndaluar dy të miturit dhe vetë dy të miturit që ishin përfshirë në këtë incident. Pas përfundimit të hetimit të këtij rasti, Avokati i Popullit i rekomandoi Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, fillimin e hetimeve në ngarkim të 2 punonjësve të Policisë së Shtetit, efektiva të Komisarariatit të Policisë Nr. 2 Tiranë, për veprën penale të “Kryerjes së veprimeve arbitrare”. Ndërkohë KShH vuri në dijeni drejtuesit e lartë të Policisë së Shtetit duke rekomanduar marrjen e masave disiplinore ndaj punonjësve të Komisarariatit, me qëllim që raste të tilla të mos përsëriten më në të ardhmen.

Përveç verifikimeve përkatëse, që KShH ka bërë për ankesa të ndryshme të ardhura në adresën tonë për ushtrim dhune fizike dhe psikologjike, trajtime çnjerezore dhe tortura, organizata jonë ka ndjekur me shumë vëmendje dhe shqyrtimin e çështjeve gjyqësore penale, lidhur me veprën e torturës. Konkretisht, është monitoruar procesi gjyqësor penal që shqyrtohej në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, në ngarkim të të pandehurve Arben Sefgjini, Avni Koldashi dhe Ilir Kumbaro, të cilët akuzoheshin, ndër të tjera, për veprën penale të “Torturës



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

me pasoja të rënda të kryer në bashkëpunim”. *Gjykimi i kësaj çështje zgjati rreth katër vjet e gjysëm dhe gjithsej u zhvilluan 124 seanca gjyqësore.* Në përfundim të gjykimit, gjykata vendosi pushimin e çështjes penale në ngarkim të disa të pandehurve për shkak të amnistimit të veprave penale për të cilat ata akuzoheshin, pushimin e gjykimit për disa të tjerë pasi nuk u provua që ta kenë kryer vepër penale dhe deklaroi fajtor për krimin e torturës me pasoja të rënda vetëm të pandehurin Ilir Kumbaro dhe e dënoi atë në mungesë me 15 (pesëmbëdhjetë) vjet burgim²⁴.

Lidhur me këtë çështje, KShH ka mbështetur deklaratat e organizatës ndërkombëtare të Amnesty International, e cila vlerëson se familjarëve të të ndjerit Remzi Hoxha iu është mohuar drejtësia dhe shteti nuk ka mundësuar gjetjen e eshtrave të të ndjerit në mënyrë që ata të bëjnë rivarrimin. Për më tepër, KShH vlerëson se gjykimi i kësaj çështje nuk është zhvilluar brenda një afati të arsyeshëm, në kontekstin e nenit 6 të KEDNJ-së duke shkelur kështu një ndër parimet kryesore siç është parimi i procesit të rregullt ligjor.

Bazuar në sa më sipër rezulton se, krahasimisht me vitet e kaluara, numri i ankesave dhe i rasteve të dhunës në institucionet penitenciare ka shënuar ulje. Pavarësisht nga kjo, për rastet e dhunës të raportuara nga institucionet penitenciare dhe në Komisaritet e Policisë, KShH vlerëson se për këto vepra duhet të punohet më shumë, që të ketë një hetim të plotë, të paanshëm, objektiv dhe profesional nga organi i prokurorisë si dhe nga strukturat e brendshme të specializuara të tilla si, Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm në Ministrinë e Brendshme dhe Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm në Sistemin e Burgjeve, në Ministrinë e Drejtësisë. KShH, thekson se hetimi dhe gjykimi i këtyre rasteve duhet bërë brenda një afati të arsyeshëm dhe se zvarritjet në kohë të proceseve dëmtojnë rëndë interesat e viktimave dhe të familjarëve të tyre. Gjithashtu kjo zvarritje, vështirëson provimin e përgjegjësisë penale për fajtorët. Nënvizojmë se, një rol të rëndësishëm në dokumentimin e rasteve të dhunës ka mjeku i institucioneve penitenciare dhe i Drejtorive të Policisë së Qarkut ose Komisariateve të Policisë. Çdo person që pretendon se është dhunuar duhet të ekzaminohet menjëherë nga mjeku dhe çdo pretendim për ushtrim dhune, së bashku me konkluzionet e mjekut, duhet të pasqyrohet në kartelat mjekësore. Dokumentimi mjekësor i rasteve të dhunës në aspektin procedural, përbën një provë shumë të rëndësishme për organin e prokurorisë ose vetë individit të dëmtuar, për ta përdorur atë në argumentimin e akuzës së ngritur. Është veçanërisht i rëndësishëm ekzaminimi mjekësor, menjëherë sapo personi ndalohet, shoqërohet ose arrestohet nga Komisaritet e Policisë, si dhe menjëherë pas transferimit të tij/saj në sektorët e paraburgimit me masën e sigurimit “arrest në burg”.

3. E DREJTA PËR LIRI DHE SIGURI

E drejta për liri dhe siguri është sanksionuar në nenin 27 të Kushtetutës, i cili parashikon se: “Askujt nuk mund t’i hiqet liria, përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj” dhe në nenin 5 të KEDNJ-së. Lidhur me këtë të drejtë GJEDNJ ka vlerësuar se që kufizimi i lirisë të jetë i ligjshëm, në kontekstin e nenit 5/1 të Konventës, duhet respektuar procedura e parashikuar në ligj²⁵ Konventa referon në legjislacionin kombëtar të shteteve palë dhe përcakton detyrimin e tyre që t’i binden rregullave substanciale dhe procedurale që kanë

²⁴ I pandehuri Ilir Kumbaro është zhdukur në adresë të panjohur pasi Mbretëria e Bashkuar refuzoi ekstradimin e tij në Shqipëri.

²⁵ Çështja *Benham k. Mbretërisë së Bashkuar*



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

krijuar, duke nënvizuar që çdo kufizim lirie duhet të jetë i pajtueshëm me qëllimin e nenit 5, në mënyrë që individët të mbrohen nga arbitrariteti.

Nga monitorimet e kryera në disa komisariate policie, KShH ka vërejtur se efektivat e policisë ndjekin “*praktika të gabuara*” që vijnë në kundërshtim me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale dhe ligjit “Për Policinë e Shtetit” për sa i takon shoqërimin, ndalimit ose arrestimit në flagrancë të shtetasve, ç’ka i privon dhe i cënon këta shtetas në gëzimin e të drejtës për liri dhe siguri. Nga kontaktet e marra me punonjësit e policisë së shtetit, gjatë monitorimeve sporadike, ka rezultuar që ngatërrohet koncepti i shoqërimin të shtetasve me ndalimin dhe arrestimin, për shkak të mosnjohjes së mirë të legjislacionit dhe të koncepteve ligjore për to.

Një tjetër problematikë e konstatuar është pasqyrimi jo i saktë i të dhënave në regjistrat përkatës, veçanërisht i momentit të hyrjes dhe daljes së personave të shoqëruar, ndaluar, ose arrestuar në/nga ambientet e Komisarariatit të Policisë. Pasqyrimi i saktë i të dhënave është një indikator i rëndësishëm që garanton respektimin e afateve të parashikuara nga ligji për shoqërimin, ndalimin dhe arrestimin e shtetasve.

Lidhur me sa më sipër, në dt. 9 Tetor 2012, KShH kreu një mision sporadik verifikimi në Komisarariatit të Policisë nr.1 në Tiranë lidhur me verifikimin e procedurave ligjore të arrestimit në flagrancë të një prej pjesëtarëve të grevës së ish të përndjekurve politikë, për shkak të një incidenti të ndodhur një ditë më parë, gjatë të cilit mbeti i demtuar nga flakët e zjarrit një prej ish të përndjekurve politikë. KShH, konstatoi se procedurat e arrestimit në flagrancë të shtetasit P.Sh, nuk ishin bërë konform nenit 252 të Kodit të Procedurës Penale, që parashikon se “*Është në gjendje flagrance ai që është kapur në kryerje e sipër të veprës penale ose ai që menjëherë pas kryerjes së veprës penale ndiqet nga policia gjyqësore, nga personi i dëmtuar ose nga persona të tjerë ose që është kapur me sende dhe prova materiale nga të cilat duket se ka kryer veprë penale*”. Nga verifikimi rezultoi se nga momenti kur kishte ndodhur ngjarja, deri në momentin kur është mbajtur procesverbali i arrestimit në flagrancë të personit kishin kaluar 6 orë, në kushtet kur personi nuk ishte në ndjekje nga policia ose persona të tjerë.

Në dt.7 Dhjetor 2012, KShH kreu një mision sporadik monitorimi në Komisarariatit të Policisë nr.3 në Tiranë, duke marrë shkas nga informacioni i publikuar prej mediave të shkruara, sipas së cilave, në mëngjesin e asaj date ishin arrestuar 5 ish të përndjekurve politikë. KShH nuk mundi të kryjë një verifikim të plotë lidhur me këtë rast pasi nuk u lejuam të futeshin në komisarariat, por nga informacioni i marrë nga shefi i Komisarariatit, rezultoi se këta pesë persona ishin marrë në Komisarariat me qëllim parandalimin të veprimtarisë së dhunshme që mund të kryenin (goditjen me domate te makinës) ndaj Presidentit të RSH, para hyrjes së tij në Këshillin e Lartë të Drejtësisë. Në vazhdim, shefi i Komisarariatit theksoi se këta persona, gjatë qëndrimit në polici, nuk ishin vendosur në dhomat e sigurisë por ishin mbajtur si të shoqëruar. Në fakt, sipas nenit 11 të Policisë së Shtetit, “*Shoqërimi, në kuptimin e këtij ligji, nënkupton rastin kur një person ka shkelur një rregull administrative dhe identifikimi i tij krijon nevojën e shoqërimin në zyrat e policisë me ose pa vullnetin e tij*”. Neni 101 i këtij ligji parashikon se “*Punonjësi i Policisë bën shoqërimin e personave në mjediset e Policisë ose në organin urdhërdhënës në rastet e mëposhtme: a) për mbikëqyrjen e të miturit për qëllime edukimi ose për shoqërimin e tij në organin kompetent; b) kur personi është përhapës i një sëmundjeje ngjitëse, i paafte mendërisht dhe i rrezikshëm për shoqërimin*”. Nga përmbajtja e këtyre dispozitave, del e qartë se në rastin e verifikuar ishim përpara ndalimit të personit, parashikuar nga neni 253 i Kodit të Procedurës Penale dhe jo shoqërimin të tyre. Neni 253 i Kodit të Procedurës Penale parashikon se personi mund të ndalohet kur dyshohet për një krim, për të cilin ligji cakton një dënim, jo më të ulët në



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

maksimum se 2 vjet, gjë për të cilën policia nuk kishte ngritur dhe nuk ngriti më pas asnjë akuzë dhe nuk kreu asnjë veprim procedural. Lidhur me këtë rast, KShH në 7 Dhjetor 2012, reagoi me anë të një deklarate për shtyp si dhe vuri në dijeni me shkresa zyrtare, Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm në Ministrinë e Brendshme.

4. BARAZIA PARA LIGJIT DHE NDALIMI I DISKRIMINIMIT

Barazia para ligjit dhe ndalimi i diskriminimit është një tjetër e drejtë e rëndësishme tek e cila jemi ndalur gjatë vitit 2012. Janë neni 18 i Kushtetutës së RSh dhe neni 14 i KEDNJ-së, që duke sanksionuar këtë të drejtë, ndalojnë diskriminimin për shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër. Në kuadër të përafrimit të legjislacionit vendas me legjislacionin e Bashkimit Evropian, Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar ligjin Nr. 10221, datë 4.2.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” (LMD). Më poshte po trajtojmë disa gjetje në këtë fushë.

▪ Diskriminimi i minoritetit Rom

KShH vlerëson se minoriteti Rom është ndër grupet më të diskriminuara të shoqërisë shqiptare. Edhe gjatë vitit 2012, u konstatua se organet e qeverisjes në Shqipëri nuk kanë marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim ndalimin e diskriminimit dhe përmirësimin e kushteve të jetësës së këtij minoriteti, sepse një ndër problemet kryesore me të cilat përballet ky minoritet është mungesa e strehimit. Për shkak të varfërisë së tejskajshme dhe papunësisë, familjet Rome migrojnë nga një zonë në tjetrën duke u vendosur në toka me pronësi shtetërore, ose në pronësi të personave të tretë. Gjithashtu edhe kur ata kanë vendqëndrim të stabilizuar, mungesa e infrastrukturës i përball ata me probleme si, mungesa e ujit të pijshëm, mungesa e energjisë elektrike, e kanalizimeve për ujrat e zeza etj, ndërsa mungesa e rregjistrimit në zyrat e gjendjes civile u shkakton përballjen me mungesën e shërbimeve shëndetësore, të shërbimeve të tjera sociale, ose mungesa e frekuentimit të shkollës ose kopshteve për fëmijët e tyre .

Në dt. 25 Janar 2012, pas një verifikimi sporadik në afërsi të Liqenit Artificial të Tiranës, vendi ku jetonin disa familje Rome, KShH reagoi me një njoftim për shtyp dhe shprehu shqetësimin se, këto familje rome kishin zbatuar vullnetarisht urdhërin e Bashkisë Tiranë për të prishur barakat e tyre, por më pas ata nuk ishin sistemuar diku tjetër, ashtu sikurse iu ishte premtuar nga kjo Bashki. Për disa ditë, në mes të ditëve të ftohta dhe me shi, dhjetra familje rome kishin qëndruar jashtë, pa asnjë strehë ose ndihmë. Midis tyre kishte rreth 26 fëmijë dhe të moshuar që ankoheshin për gjendje jo të mirë shëndetësore. Në datën 31 Janar 2012, KShH kreu një mision të dytë sporadik monitorimi, me qëllim për të parë nëse ishin marrë masat për akomodimin e këtij komuniteti në një mjedis të përshtatshëm për jetesë. Rezultoi e njëjta situatë e rëndë. Për të dyja konstatimet KSHH, njoftoi Bashkinë e Tiranës dhe i kërkoi asaj marrjen e masave për strehimin e këtyre familjeve rome, duke i kujtuar Bashkisë së Tiranës, por edhe Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shansëve të Barabarta, se sjellje dhe veprime të tilla ndaj këtij komuniteti, lënia e tyre për ditë me radhë në një situatë pasigurie për jetën dhe në kushte të rënda atmosferike, përbënte shkelje të së drejtës së jetës, trajtim ç’njëzëor, degradues dhe diskriminues për ta, si dhe cënim të së drejtës për respektimin e jetës private dhe familjare, të drejta këto të sanksionuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe në Konventën Evropiane të Drejtave të Njeriut.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

KShH-së iu desh të reagojë përsëri më dt. 3 Shkurt 2012, për shkak të mungesës së reagimit dhe veprimit nga ana e organeve kompetente. Në këtë deklaratë, KShH mbështeti, gjithashtu, interesimin e menjëhershëm të Avokatit të Popullit, ndërhyrjet e tij pranë autoriteteve publike, si dhe strehimin në ambientet e tij të disa familjeve rome, barakat e të cilave ishin prishur në një zonë tjetër të Tiranës. KShH gjithashtu, së bashku me një rrjet organizatash të shoqërisë civile, nëpërmjet një deklaratë të përbashkët²⁶, i bënin thirrje Bashkisë së Tiranës si dhe institucioneve të tjera përgjegjëse në nivel vendor dhe qendror, të gjenin një zgjidhje të menjëhershme dhe të qëndrueshme për familjet rome të mbetura pa strehë, ndërkohë që në datën 7 Shkurt 2012, së bashku me organizatën hungareze, Qendra Evropiane për të Drejtat e Romëve (ERRC)²⁷ iu drejtua sërish me një letër të hapur Bashkisë së Tiranës dhe MPÇSSH. Në këtë letër të dyja organizatat i bënin thirrje autoriteteve të pezullonin dëbimet e Romëve nga vendqëndrimet e tyre dhe të vepronin me urgjencë për t'i siguruar këtij minoriteti strehim të përshtatshëm, në përputhje me kushtet klimaterike dhe në kontekstin e një procesi të rregullt ligjor, komuniteti Rom duhej konsultuar gjerësisht, me qëllim gjetjen e një zgjidhje afatgjate që do të mundësonte strehimin dhe sigurinë e tyre shëndetësore. Edhe për këtë reagim publik nuk morrëm asnjë përgjigje nga institucionet të cilave iu adresoheshim.

Në dt. 4 Maj 2012, KShH kreu një mision tjetër monitorimi në vendin pranë liqenit artificial. Qëllimi i verifikimit ishte monitorimi i kushteve të jetesës së familjeve rome si dhe masat e marra nga institucionet shtetërore, sikurse ishte premtuar disa herë publikisht. Nga verifikimi rezultoi se familjet Rome nuk ishin kontaktuar nga asnjë përfaqësues i MPÇSSH apo Bashkisë Tiranë, në mënyrë që të diskutohej me ta për sa i takon zhvendosjes dhe strehimit të tyre në një ambient të ri. Ata deklaruan se ishin kontaktuar vetëm nga disa policë bashkiakë, të cilët kërkonin prej tyre që të largoheshin diku tjetër. Edhe pse kishin kaluar gati 4 muaj, ende nuk u ishte dhënë zgjidhje problemeve me të cilat përballeshin familjet rome të vendosura pranë liqenit artificial.

Lidhur me situatën e të drejtave të minoritetit Rom, në datat 14 dhe 18 Prill 2012, KShH kreu dhe dy misione monitorimi në qytetin e Gjirokastrës, të nxitur nga nevoja për verifikimin e ankesës së ardhur në adresë të organizatës tonë nga disa familje Rome të vendosura buzë lumit Drino, të cilët kishin mungesë të ujit të pijshëm dhe të energjisë elektrike. Nga verifikimi rezultoi se, këta shtetas ishin zhvendosur nga qyteti i Korçës në atë të Gjirokastrës. Ato jetonin në çadra plasmasi dhe kushtet e jetesës së tyre ishin tepër të vështira. Familjet kishin probleme serioze me furnizimin me ujë të pijshëm dhe energji elektrike, të cilin e siguronin nëpërmjet lidhjeve jo të sigurta, jashtë kushteve teknike, nëpërmjet personave private, ç'ka përbënte një rrezik për jetën e tyre. Lidhur me këtë konstatim, KShH në bashkëpunim me organizatën suedeze Civil Rights Defenders, iu drejtua Bashkisë së Gjirokastrës dhe MPÇSSH, si dhe informuam Avokatin e Popullit, duke sugjeruar gjetjen e zgjidhjeve të sigurta, me qëllim garantimin e funizimit të vazhdueshëm me drita e ujë të pijshëm të këtij komuniteti, brenda kushteve teknike, për t'i mundësuar atij zhvillimin e një jetese normale, si dhe konsultimin paraprak me ta. Në dt. 23 Maj 2012, në përgjigjen zyrtare, Bashkia e Gjirokastrës thekson ndër të tjera se, e konsideron sugjerimin e dy organizatave të drejtë dhe se do të ndërmerren të gjitha hapat e duhura për të studiuar zonën e Lagjes Zinxhira dhe për të hartuar projektet për zgjidhjen e problemit të sistemit të 30 familjeve Rome. Në letrën e saj, Bashkia theksonte se ka hartuar dhe dërguar, pranë Ministrive dhe Institucioneve Qendrore, disa projekte për komunitetin Rom

²⁶ Deklarate e dates 3 shkurt 2012, Për më shumë shih faqen e internetit www.ahc.org.al

²⁷ Organizatë e njohur për veprimtarinë e saj për mbrojtjen e të drejtave të minoritetit rom. Për më shumë shih www.errc.org



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

që jetonte në territorin e kësaj bashkie, por ato nuk janë financuar dhe mbështetur nga pushteti qendror.

Një tjetër ngjarje që cenoi të drejtat e komunitetit Rom në Tiranë ishte ajo e muajit Korrik, kur Policia Bashkiake e Tiranës ndërmori një operacion duke sekuestruar mjete dhe produkte (*karroca, material plastike, metalike etj*), me të cilat anëtarë të ndryshëm të minoritetit Rom punonin dhe nxirrnin jetesën e përditëshme. KShH u bë pjesë edhe në grupin e punës “*ad hoc*” që Avokati i Popullit ngriti për diskutimin e këtij problemi dhe në datën 6 Gusht 2012, reagoi me anë të një deklaratë për shtyp, duke kërkuar që problemet e këtij komuniteti të zgjidheshin nëpërmjet masave të përshtatshme, të karakterit social ekonomik, duke respektuar barazinë e shtetasve Rom me shtetasit e tjerë.

▪ *Ndjekja e rasteve për veprime diskriminuese për grupe të tjera vulnerabël*

Gjatë vitit 2012, viktimitë e akteve të ndryshme me karakter diskriminues, të kryera në mënyrë direkte, ose indirekte, kanë qenë edhe gratë, fëmijët dhe personat me aftësi të kufizuara. Për këtë arsye, KSHH në mënyrë individuale, ose së bashku me organizata të tjera të shoqërisë civile kanë reaguuar publikisht, me qëllim ushtrimin e presionit ndaj institucioneve shtetërore përkatëse, për marrjen e masave që do të rivendosnin në vend të të drejtat e shkelura.

Kështu, duke ju referuar raportimit në emisionin televiziv “Fiks Fare” dhe artikujve të shumtë në shtypin e përditshëm, dëshmime të grave të strehuara në Qendrën Kombëtare për Rehabilitimin e Viktimave të Dhunës në Familje, si dhe të punonjëseve të kësaj qendre, rezultonte e qartë se disa nga urdhrat e dhënë nga drejtoresha e këtij institucioni publik ishin diskriminues dhe vinin në kundërshtim me të drejtën për një trajtim human dhe parimin e përgjegjshmërisë administrative. Në datë 23 Prill 2012, KShH së bashku me një rrjet organizatash të shoqërisë civile, reagues me anë të një letre të hapur, drejtuar MPCSSH, lidhur me mënyrën joprofesionale dhe diskriminuese me të cilën janë trajtuar gratë dhe fëmijët e strehuar në Qendrën Kombëtare për Rehabilitimin e Viktimave të Dhunës në Familje, nga drejtoresha e këtij Institucioni. Gjithashtu, në këtë letër ju kërkua MPCSSH, shkarkimi i drejtoreshës së sipërcituar, sugjerim që u morr në konsideratë.

Në fillim të muajit Dhjetor 2012, KShH ka ndjekur me shqetësim deklaratat e personave me aftësi të kufizuara dhe organizatave që kanë në fokus të drejtpërdrejtë mbrojtjen e interesave të tyre, se prej tre muajsh kjo kategori shumë vulnerabël e shoqërisë shqiptare, nuk kishte marrë pagesat që u takon sipas ligjit. Megjithatë, KShH përshendet ratifikimin nga Kuvendi i Shqipërisë, në dt.15 Nëntor 2012, të Konventës së OKB-së “*Për të drejtat e Personave me aftësi të Kufizuara*” dhe shpresojmë se implementimi i këtij akti ndërkombëtar do t’i përforcojë dhe zgjerojë të drejtat për personat me aftësi të kufizuara, por nënvizojmë se, ndërsa shteti shqiptar ndërmerr angazhime të reja ndërkombëtare, është i papranueshëm fakti që nuk zbatohet kuadri ligjor i brendshëm, që u akordon pagesat mujore përkatëse personave me aftësi të kufizuara.

• *Diskriminimi në marrëdhëniet e punës*

Gjatë vitit 2012, në kuadër të Klinikës Ligjore Falas, KShH ka marrë 9 ankesa nga persona të cilët kanë pretenduar se janë diskriminuar në fusha të ndryshme të jetës. Ankesat kanë qenë kryesisht lidhur me diskriminimin në marrëdhëniet e punës, diskriminimi në trajtimin e



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

diferencuar të personave të privuar nga liria nga administrata e burgjeve/paraburgimit, pretendime për ekzistencën e praktikave të korrupsionit pasiv, diskriminimit në gëzimin e të drejtave të tjera me natyrë ekonomike-sociale etj. Një nga ankesat që i është adresuar KShH-së ka të bëjë me largimin nga puna për shkaqe diskriminuuese. Ankuesja, i ishte drejtuar më parë Komisioneres për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD), e cila kishte konstatuar me vendim diskriminimin e ankueses nga Drejtoria Rajonale Shëndetësore Fier, në formën e viktimizimit, për shkak të denoncimeve të bëra nga ana e saj lidhur me veprimtari të asaj Drejtorie. KMD, i kishte rekomanduar këtij institucioni kthimin në vendin e punës të ankueses, por ky vendim nuk ishte zbatuar. Nga korrespondenca që KShH pati me KMD-në lidhur me këtë rast, u informuam se në zbatim të kompetencave të saj ligjore, KMD i kishte vënë gjobë subjektit ndaj të cilit ishte bërë ankesa. Pavarësisht nga kjo, ankuesja nuk është kthyer në vendin e saj të punës. KShH, nëpërmjet Klinikës Ligjore Falas, po e ndihmon këtë qytetare të gjeje rrugët ligjore, të mëtejshme, për mbrojtjen nga diskriminimi që i është bërë.

5. E DREJTA PËR NJË PROCES TË RREGULLT LIGJOR

Neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së sanksionojnë të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Në ndryshim nga të drejtat e tjera themelore, përgjithësisht, kjo e drejtë ka natyrë procedurale dhe është absolute²⁸. E drejta për një proces të rregullt ligjor në gjykatë është pjesë thelbësore e kësaj të drejte dhe mbron edhe aksesin e shtetasve në organet e drejtësisë.

Në kuadër të programit Klinika Ligjore Falas, KShH ka trajtuar 30 ankesa që i adresohen organeve të pushtetit gjyqësor²⁹. Disa ankesa kanë patur të bëjnë me mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, të cilat në të shumtën e rasteve i janë adresuar përsëri sistemit gjyqësor, duke kërkuar mbrojtjen e të drejtës për proces të rregullt gjyqësor që është çenuar si rezultat i vonësive në ekzekutimin e vendimit. Ankesat e shtetasve për proces të parregullt gjyqësor, ose për vendime të padrejta gjyqësore, janë të lidhura, kryesisht, me çështjet penale dhe për çështje civile të pronësisë.

Nga kontaktet dhe komunikimi me këtë kategori ankuesish, rezulton se besimi i shtetasve në organet e drejtësisë është shumë i ulët, ekziston gjërësisht perceptimi se gjyqtarët janë të korruptuar, të njëanshëm dhe në disa raste ankuesit shprehen se e vetmja mënyrë për të vendosur drejtësi në Shqipëri është vetëgjyqësia.

Lidhur me këto ankesa, duke respektuar parimin e sanksionuar në nenin 145 të Kushtetutës se, “Gjyqtarët janë të pavarur dhe u nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve”, KShH ju ka sugjeruar ankuesve t’i drejtohen Këshillit të Lartë të Drejtësisë, për të shprehur rezervat e tyre ndaj performancës së gjyqtarëve, ose të ushtrojnë të drejtën e ankimit në gjykatën më të lartë. Megjithatë, në disa raste, kemi kryer monitorime të proceseve gjyqësore, në kuadër të ankesave të ndryshme që qytetarët na kanë adresuar, ose kemi marrë përsipër shërbimin ligjor falas.

Vëzhguesit e KShH-së kanë monitoruar gjatë vitit **26 seanca gjyqësore për disa nga çështjet më sensitive**, ndër të cilat çështjen penale me të pandehur tre ish anëtarët e Gardës së RSH që akuzohen për vrasjen e 4 viktimave të demonstratës së 21 Janarit, çështjen penale të iniciuar nga familjarët e viktimave të tragjedisë së Gërdecit kundër ish Ministrit të Mbrojtjes dhe çështjen

²⁸ Nuk mund të kufizohet në asnjë rrethanë;

²⁹ 7 ankesa për proces të parregullt gjyqësor dhe 17 ankesa për vendime të padrejta gjyqësore;



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

penale kundër ish drejtorit të Policisë Bashkiake, që akuzohej nga Prokuroria e Tiranës për dhunimin e dy ish punonjësve të Bashkisë së Tiranës në ambientin e punës.

Disa nga problematikat e përgjithshme, që janë konstatuar nga monitorimet, kanë qenë: vonesat e gjata në fillimin e gjykimit të çështjes dhe mos respektimi i orarit të përcaktuar nga vetë gjykata; mosrelatimi nga gjyqtari i çështjes ose trupi gjykues i shkakut të vonesës, siç detyron ligji; mbivendosja e orareve të seancave gjyqësore, për çështje të ndryshme që gjykoheshin nga i njëjti trup gjykues; zhvillimi i seancave në salla të vogla, duke penguar aksesin e qytetarëve në gjykatë, ç'ka vjen në kundërshtim me parimin e publicitetit të gjykimit; mospërdorimi i veshjeve të posaçme për seancat e gjykimit; shtyrje e çështjeve në mënyrë abuzive nga palët, ç'ka pengonte gjykimin e shpejtë të çështjes, brenda një afati të arsyeshëm, mosparaqitje të avokatëve ose prokurorëve të çështjes etj.

Më në detaj konstatimet tona kanë qenë si vijon. Nga monitorimi i 9 seancave gjyqësore të çështjes penale me të pandehur tre anëtarët e Gardës së RSH, që akuzohen për vrasjen e 4 viktimave të demonstratës së 21 Janarit të 2011-ës, rezultoi se gjykimi, deri në momentin e monitorimit, ka qenë i vazhdueshëm dhe distanca kohore midis datave të seancave ka qenë e arsyeshme, duke patur në konsideratë, në këtë rast, kompleksitetin, dinamikën e gjykimit dhe numrin e lartë të provave të administruara në gjykim. Në seancat gjyqësore të monitoruara janë thirrur një numër i konsiderueshëm dëshmitarësh dhe disa ekspertë të fushave të ndryshme. Kubatura e vogël e sallës dhe pjesëmarrja e lartë e publikut në seancë ka bërë që një pjesë e tyre të mos kishin akses në seancë gjyqësore. Gjithashtu, refuzimi i pranimit për shqyrtim i padisë civile për dëmshpërbim, të paraqitur në këtë proces penal nga familjarët e viktimave të 21 Janarit, për shkak të pamundësisë së tyre për të paguar taksën e padisë, me vlerë 3% e shumës së dëmshpërbimit të kërkuar, mendojmë se i privoi familjarët e viktimave për të patur akses në gjyqësor. Me sa jemi të informuar cenimi i kësaj të drejte i është paraqitur GJEDNJ-së për shqyrtim, nëpërmjet Qendrës “Res Publica”.

KShH monitoroi 4 seanca gjyqësore të çështjes penale me të pandehur ish Drejtorin e Policisë Bashkiake të Tiranës, i cili akuzohej nga prokuroria se kishte dhunuar fizikisht, në ambientet e Bashkisë së Tiranës, dy punonjëse të këtij institucioni. Nga monitorimi rezultoi se ka patur disa shtyrje të seancave, me kërkesë të të pandehurit, ose avokatit të tij, ndërsa në një seancë, prania e madhe numerike e punonjësve të policisë bashkiake, kolegë të të pandehurit, shkaktoi konfuzion gjatë gjykimit. Gjithashtu kolegët e të pandehurit, me gjeste fyese, kanë replikuar gjatë gjykimit me kallëzuesen. Këto veprime aspak profesionale, që cenojnë rëndë solemnitetin e gjykimit dhe shkaktojnë vuajtje të mëtejshme tek viktimat, janë veçanërisht të rrezikshme, sidomos kur kryhen nga efektivi të policisë, që kanë për detyrë të ruajnë qetësinë dhe rendin. Pas muajsh të tërë gjykimi, të shtyrë vazhdimisht me kërkesë të palës së pandehur, në dt. 14 Nëntor 2012, gjykata vendosi të pushojë çështjen, me arsyetimin se ajo nuk duhej të kishte filluar pasi përbënte kundravajtje penale dhe duhej ndjekur në gjykata me kërkesë të të dëmtuarës akuzuese dhe jo me kërkesë të prokurorisë. Ne jemi të mendimit, që në këtë rast, gjykata kishte të gjitha mundësitë proceduriale për t'i marrë pëlqimin të dëmtuarës dhe të vazhdonte gjykimin, i cili kishte filluar dhe vazhduar prej kohësh.

KShH monitoroi, gjithashtu, 5 seanca gjyqësore të çështjes penale të gjykuar në Gjykatën e Lartë, e cila ishte iniciuar nga familjarët e viktimave të “Tragjedisë së Gërdecit” kundër ish Ministrit të Mbrojtjes, të cilin e akuzonin për kryerjen e veprës penale “Plagosje e rëndë nga pakujdesia”. Në datë 10 Dhjetor 2012, Gjykata e Lartë vendosi të pushojë gjykimin e çështjes për shkak të hyrjes në fuqi të ligjit për amnistinë, që përfshinte edhe veprën penale për të cilën akuzohej ish Ministri.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Lidhur me këto çështje të monitoruara, dëshirojmë të theksojmë se pavarësia, paanshmëria dhe profesionalizmi i punonjësve të organit të prokurorisë dhe në mënyrë të veçantë, të organeve e pushtetit gjyqësor, janë tregues thelbësorë të ekzistencës së shtetit ligjor. Në mënyrë të veçantë, kur autorë të veprave penale janë persona të veshur me funksione shtetërore, shteti nëpërmjet organeve të drejtësisë penale, duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme, me qëllim që t'i tregojë mbarë opinionit publik që asnjë krim nuk ngelet pa u ndëshkuar dhe se përpara ligjit jemi të gjithë të barabartë. Pandëshkueshmëria e funksionarëve publikë cenon rëndë sistemin e drejtësisë dhe standartet e shtetit të së drejtës.

▪ *Parimi i sigurisë juridike*

Nga jurisprudenca dhe doktrina tashmë është pranuar se një nga aspektet themelore të shtetit të së drejtës është dhe parimi i sigurisë juridike. Duke u nisur prej disa ankesave, që na u adresuan nga disa ish ushtarakë, përfitues të pensionit të parakohshëm, të cilët ankoheshin se nga muaji Tetor 2011, Instituti i Sigurimeve Shoqërore u kishte ulur në mënyrë të konsiderueshme masën e pensionit të tyre, KShH kreu takime me përfaqësues të institucionit përkatës dhe shkëmbeu korrespondencë zyrtare me ta. Nga verifikimi rezultoi se, lidhur me këtë çështje, qeveria shqiptare ka miratuar aktet ligjore dhe nënligjore³⁰, të cilat vijnë në kundërshtim me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.33, datë 24.06.2010. Më anë të këtij vendimi, Gjykata Kushtetuese kishte vendosur shfuqizimin si antikushtetues, të pikës 2 të nenit 14 dhe nenin 27 të ligjit nr.10142, datë 15.05.2009³¹. Në këtë vendim Gjykata Kushtetuese shprehet se *“Qëllimi i dispozitave të nenit 29 të ligjit objekt gjykimi, duke u nisur nga konteksti i saj, si dhe konteksti i përgjithshëm i këtij ligji, është që kjo rillogaritje e këtyre të drejtave të fituara në zbatim të ligjeve të mëparshme ose dhe të vendimeve të gjykatave, do të bëhet vetëm në rast se ndryshon pozitivisht, pra për mirëson situatën e përfituesve. Në asnjë rast nuk lejohet që të kryhet një rillogaritje që do të çonte në përkeqësimin e situatës pozitive ose në cenimin e të drejtave të fituara. Në rast të kundërt, ... do të ishim përpara cenimit të parimit të sigurisë juridike”*. Lidhur me këtë çështje, është shumë shqetësues fakti se aktet ligjore dhe nënligjore të miratuara, pas dhënies së këtij vendimi nga Gjykata Kushtetuese, vijnë në kundërshtim të hapur me atë që kjo Gjykatë ka vendosur dhe argumentuar, duke cënuar sërish edhe për këtë shkak, parimin e sigurisë juridike. Për këtë arsye aktet ligjore të sipërcituara janë kundërshtuar përsëri nga një shoqatë ushtarakësh në Gjykatën Kushtetuese dhe pritet gjykimi i saj. KShH shpreh shqetësim sepse, në kushtet kur Gjykata Kushtetuese ka dhënë disa vendime në mbrojtje të të drejtave për përfitimin nga sigurimet shoqërore të ish ushtarakëve, ata vazhdojnë akoma të përballen me akte ligjore dhe nënligjore që çenojnë të drejtat dhe interesat e tyre, gjë që i vendos ata në një gjendje pasigurie, si dhe ju krijon vështirësi për jetesë.

Gjithashtu, më 19 Tetor 2012, KShH reagoi me një deklaratë për shtyp lidhur me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 17.10.2012, me anë të të cilit urdhërohej shpërndarja e grevës së ish të përndjekurve politikë. KShH, vuri në dukje parregullsitë e rënda procedurale dhe materiale të këtij vendimi dhe me kërkesë të të interesuarve, përgatiti ankimimin drejtuar Gjykatës së Apelit Tiranë. KShH theksoi në deklaratën për shtyp se, vendime gjyqësore të tilla

³⁰ Ligji nr.10367, datë 23.12.2010 “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr.5, dt.10.11.2010 të KM “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10142, datë 15.05.2009” dhe VKM nr.793, dt.24.09.2010 “Për zbatimin e ligjit nr.10142, dt.15.05.2009”

³¹ “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në RSh”



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

përbëjnë precedentë të rrezikshëm dhe me pasoja të dëmshme për gëzimin dhe ushtrimin e të drejtës së shtetasve për të manifestuar, sepse gjykata ishte shprehur me vendimin e saj për një çështje që nuk hynte në juridiksionin e saj dhe ka zgjidhur thelbin e kërkesës, pa thirur më parë palën e paditur dhe pa i dhënë asaj mundësi të shprehej në gjykim. Gjykata e Apelit Tiranë ende nuk e ka marrë në shqyrtim ankimin, ndonëse ai është ankim i veçantë dhe duhet shqyrtuar me përparësi, sipas ligjit.

Në dt.9 Nëntor 2012, KShH monitoroi në Gjykatën e Apelit shqyrtimin gjyqësor të një çështje tjetër në ngarkim të një grevisti, ish i përndjekur politik. Grevisti A.P, kundërshtonte masën e sigurimit “arrest në burg”, dhënë kundër tij nga gjykata e rrethit gjyqësor Tiranë, lidhur me një akuzë penale të ngritur nga Prokuroria. Një shkëlqje e rëndë e evidentuar nga avokati i të pandehurit ishte se kërkesën e të pandehurit për përjashtimin e gjyqtarës nga gjykimi e kishte gjykuar vetë ajo, ndryshe nga se parashikon Kodi i Procedurës Penale.

Objekt i veprimtarisë së Klinikës Ligjore Falas të KShH-së është ofrimi i shërbimeve ligjore falas, për shtetas të ndryshëm që për shkak të pamundësisë financiare nuk e kanë të mundur të kenë akses të menjëhershëm në organet e drejtësisë. Për t’u ardhur sadopak në ndihmë këtyre shtetasve, meqënëse dhe shërbimi ligjor falas shtetëror nuk ka funksionuar sa e si duhet, avokatët e KShH-së kanë ofruar një sërë shërbimesh ligjore, të tilla si: trajtim të rasteve të paraqitura, këshillim ligjor (179 raste), asistim në plotësimin e dokumentacionit (10 raste), ndërhyrje në institucionet shtetërore (202 raste), reagime publike (14 raste), etj. Në raste të veçanta, KShH ka përfaqësuar dhe vazhdon të përfaqësojë disa çështje në gjykatat e nivelit të ndryshëm. Çështjet e përfaqësuara nga KShH janë kryesisht çështje që kanë të bëjnë me litigime strategjike dhe kanë si qëllim çarjen e praktikave të reja gjyqësore, ose ndryshimin e legjislacionit, duke i ardhur në ndihmë një kategorie më të gjerë personash se përfituesit e drejtpërdrejtë.

Një çështje e tillë ishte ajo penale që u përkiste të pandehurve A.Lika dhe V.Laska³². Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në datën 7 mars 2012, pasi shqyrtoi kërkesën e të dënuarve A.Lika dhe V.Laska të përfaqësuar nga KShH³³, për rishikimin e vendimit penal të formës së prerë, të dhënë ndaj tyre në dt.5 Prill 2012, i dha fund përpjekjeve disa vjeçare të ankuesve të sipërcituar dhe vendosi që vendimi i fajsisë të rishikohej nga Gjykata e Apelit Shkodër, për shkak se ai ishte rezultat i një procesi të parregullt, konstatim ky i bërë më parë në vendimin përkatës të GJEDNJ-së. Ky vendim i Gjykatës së Lartë pati rëndësi të veçantë, jo vetëm për të pandehurit, por edhe për gjithë praktikën gjyqësore në vend, sepse krijoi një mundësi reale për vënien në zbatim të vendimeve të GJEDNJ-së, lidhur me konstatimin e procesit të parregullt për çështjet penale të shqyrtuara nga sistemi ynë gjyqësor, duke shkëlqur nenin 6 të KEDNJ. Zgjidhja mund të kishte ardhur edhe nëpërmjet amendimeve ligjore, por klasa politike në vend nuk kishte mundur, prej shume vitesh, të krijonte shumicën e duhur të votave në Kuvend për kryerjen e përmirësimeve në dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, ndërkohë që moszbatimi i vendimeve të GJEDNJ-së ishte bërë një fakt shqetësues për shtetasit që kishin fituar gjyqin në Strasburg, si dhe në kuadër të plotësimit të kërkesave për integrimin në BE.

³² Në vitin 2002, ankuesit A.Lika dhe V.Laska u dënuan nga gjykata e rrethit gjyqësor Pukë me 13 vjet burgim secili për veprat penale të vjedhjes me armë dhe atë të armëmbajtjes pa leje, vendim ky i lënë në fuqi nga gjykata e Apelit Shkodër dhe Gjykata e Lartë. Duke marrë shkas nga shkëlqet serioze të vëna re gjatë gjykimin të çështjes, në vitin 2004, çështja u paraqit pranë Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut në Strasburg. Në prill të vitit 2010, Gjykata e Strasburgut vendosi se e drejta e aplikantëve për një gjykim të drejtë ishte shkëlqur rëndë nga autoritetet gjyqësore shqiptare dhe se rigjykimi i çështjes në nivel kombëtar përfaqësonte të vetmin mjet efektiv për rivendosjen në vend të të drejtave të tyre të shkëlqura. Pas këtij vendimi, të interesuarit iu drejtuan në Nëntor të vitit 2010, Gjykatës së Lartë për ekzekutimin e drejtpërdrejtë të vendimit të Gjykatës së Strasburgut, në mungesë të parashikimit ligjor në Kodin e Procedurës Penale.

³³ Ndjekja e kësaj çështjeje u mbështet financiarisht dhe me ekspertize nga Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (Soros)



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Një praktikë e re pune, e përdorur në këtë gjykim, ishte përgatitja nga ekspertë të pavarur dhe dërgimi në Gjykatën e Lartë i një Opinioni Ligjor (Amicus Curia), lidhur me mundësitë juridike që ofron sistemi ligjor shqiptar për rishikimin e vendimit gjyqësor penal, të deklaruar si rezultat i një procesi jo të rregullt nga GJEDNJ, si dhe praktikata e aplikuara në vende të tjera demokratike për këtë qëllim. Gjykata e Lartë pranoi, për herë të parë, një material të tillë këshillues.

Megjithatë, duhet të bëjmë me dije se, që prej muajit shtator 2012, çështja është duke u rishqyrtuar në Gjykatën e Apelit Shkodër dhe vazhdon të përfaqësohet nga avokatët e Klinikës Ligjore të KShH-së.

Një çështje tjetër që KSHH po ndjek që prej vitit 2011, është përfaqësimi i rastit të një personi që ka humbur jetën në kushte ç'njerëzore në ambientet e një spitali publik, ku ishte shtruar për t'u mjekuar, gjatë kohës që ishte i burgosur dhe vuante një dënim penal. Prokurori ka vendosur refuzimin e ndjekjes penale lidhur me këtë ngjarje, ndonëse autopsia e viktimës jepte indicie të qarta për mundësinë e torturimit ose trajtimit çnjerëzor të tij (*shenja prangash ne kyçet e duarve, mungesë medikamentesh në gjakun e tij, ndonëse ishte në kurim prej disa ditësh, mungesë të theksuar higjienë dhe papastërti në trupin e viktimës etj*). Krahas kundërshtimit në gjykatë të vendimit të prokurorit për mosfillim të ndjekjes penale, KShH paraqiti një ankimim në Prokurorinë e Përgjithshme dhe kërkoi edhe kontrollin administrativ mbi vendimin e mosfillimit të çështjes penale. Çështja është ende në proces shqyrtimi në Gjykatën e Lartë dhe Prokurorinë e Përgjithshme, pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk pranoi legjitimitimin e vëllait të të ndjerit për një ankim të tillë dhe gjykata e Apelit la në fuqi këtë vendim. Bazuar në përgjegjësinë e lartë ligjore që kanë strukturat e shtetit për mbrojtjen e jetës së personave që vuajnë dënimet me burgim, siç kemi cituar edhe më lart në këtë material, KShH është e mendimit se është në interes të vetë viktimës, trashëgimtarëve të tij, por edhe në interes publik që raste të tilla të hetohen plotësisht dhe jo të refuzohet ndjekja penale, pa kryher asnjë hetim. Praktika e GJEDNJ dhe doktrina e të drejtave të njeriut ka shembuj të shumtë që orientojnë drejtë në këtë drejtim. Për këtë arsye, KShH po përfaqëson çështjen në Gjykatën e Lartë³⁴ dhe do të ezaurojë, po të jetë nevoja, të gjitha mjetet e mundshme juridike.

6. MIRËQEVERISJA DHE AKSESI I QYTETARËVE NË ORGANET E QEVERISJES QENDRORE DHE VENDORE

Mirëqeverisja në një shtet demokratik është e lidhur edhe me mënyrën se si institucionet shtetërore administrojnë çështjet dhe përdorin mjetet publike, me qëllim garantimin dhe respektimin e të drejtave të njeriut, ndërkohë që ky koncept është i lidhur edhe me pjesëmarrjen e qytetarëve në qeverisje, garantimin e transparencës për veprimtarinë e kryer nga organet e qeverisjes, përgjegjshmërinë, efektivitetin e tyre etj. Në demokraci, pushteti jo vetëm gjenerohet nga vota e lirë e popullit, por edhe gjatë ushtrimit të tij, organet e pushtetit janë të detyruara të bashkëveprojnë me shtetasit në të mirë të vendit, ruajtjen e paqes dhe stabilitetit, si dhe rritjen e mirëqenies së shtetasve.

Nisur nga sa më sipër, një ndër objektivat kryesorë të programit të organizatës është mbrojtja më e mirë e të drejtave të individëve dhe të grupeve të pambrojtura në raportet e tyre me institucioneve shtetërore. Në këtë kuadër, përveç marrjes së ankesave nga shtetasit, janë

³⁴[1] Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

zhvilluar një sërë monitorimesh sporadike, disa prej të cilave janë përmendur në rubrikat e mësipërme, kryesisht në kapitujt që kanë në trajtim verifikimin e shkeljeve të pretenduara e të adresuara nga shtetasit. Përveç kësaj, KShH ka zhvilluar monitorime të planifikuara për të vëzhguar aksesin e qytetarëve në organet e pushtetit vendor.

Nga kjo veprimtari na ka rezultuar se, me gjithë përmirësimet gjatë viteve të fundit, administrata publike, vazhdon të ketë mangësi lidhur me nivelit e kompetencës, transparencës dhe përgjegjshmërisë në dëgjimin e publikut dhe zgjidhjen e problemeve që ai adreson. Një gjë e tillë është konstatuar dhe evidentuar edhe në Progres Raportin e fundit për Shqipërinë të Komisionit Evropian (Tetor 2012).

Gjatë vitit 2012, KShH ka marrë ankesa të ndryshme nga qytetarë lidhur me veprimtarinë e institucioneve të administratës publike. 18 ankesa janë adresuar për procedura të parregullta ose jo transparente nga organet e administratës qendrore dhe vendore, 3 ankesa janë adresuar për sa i takon mënyrës së akordimit të ndihmës ekonomike dhe pensioneve dhe masës së tyre, 2 ankesa kanë të bëjnë me cenimin e të drejtës për t'u informuar nga institucionet e administratës publike.

KShH ka kryer verifikime në vend, nxitur nga sinjalizimet dhe ankesat e marra nga shtetasit, por edhe nga media e shkruar dhe ajo elektronike. Në dt.28 Qershor 2012, KShH kreu një mision sporadik verifikimi në Komunat Bushat dhe Bërdicë të Qarkut të Shkodrës, duke marrë shkas nga protestat e banorëve të fshatit Trush të Komunës Bërdicë, të cilët protestonin për moszbatimin e VKM-së për pagimin e kompensimit të dëmeve në kulturat bujqësore dhe biznese, të shkaktuara nga përmbytjet të fundit të vitit 2010 dhe në fillim të vitit 2011. Nga verifikimi rezultoi se asnjë prej banorëve në zonat e përmbytura të Qarkut Shkodër nuk ishte kompensuar për dëmet e shkaktuara nga përmbytjet, megjithëse prej kohësh kishte përfunduar procesi i vlerësimit të dëmeve nga komisionet e ngritura sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave. Nisur nga situata e rëndë e konstatuar, më 2 Korrik 2012, KShH reagoi me një deklaratë për shtyp, duke vënë theksin tek fakti se qeveria duhet të vlerësojë më mirë dhe t'u përgjigjet në kohën e duhur, halleve dhe shqetësimeve të shtetasve të vetë, në mënyrë të veçantë kur vetë strukturat e shtetit janë përgjegjëse direkt apo indirekt, për shkaktimin e dëmeve. Detyrimet që shteti merr përsipër, nëpërmjet akteve ligjore që miraton, duhet të përmbushen detyrimisht, në të kundërt kjo, jo vetëm ul besimin e popullit tek organet qeverisëse, por tregon se shteti i të drejtës nuk funksionon si duhet. Një problematikë tjetër e evidentuar nga ky verifikim ishte se, si pasojë e përmbytjeve ishin dëmtuar kanalet vaditëse të Komunës Bërdicë dhe për rrjedhojë banorët nuk ujinin dot kulturat e tyre bujqësore, për të siguruar mjetet e nevojshme të jetesës. Lidhur me këtë çështje, KShH vuri në dijeni Ministrinë e Bujqësisë dhe Bordin e Kullimit Shkodër. Në dt.1 Gusht 2012, Bordin i Kullimit Shkodër kthen përgjigje dhe na informoi se ishte në dijeni të gjendjes së kanaleve vaditëse, por gjendja sipas tyre, nuk pengonte punën e banorëve të zonës dhe se në të ardhmen do merren masat e nevojshme për të bërë studime dhe projekte për rehabilitimin e pjesëve të dëmtuara.

Gjatë muajit Shtator 2012, disa shtetas dhe përfaqësues të Shoqatës së Qiramarrësve në Shtëpitë Shtetërore, ish pronë private, adresuan ankesat e tyre pranë nesh lidhur me pasojat negative që pësonin nga zbatimi i Aktit Normativ të Këshillit të Ministrave, nr.3 datë 1.08.2012, "*Për lirimin e banesave të pronarëve të ligjshëm nga qytetarët e pastrehë, banues në banesat ish-pronë e subjekteve të shpronësuar*", i cili u cënonte këtyre personave të drejtën për strehim në banesat që kishin kontraktuar me shtetin, prej më shumë se 20 vitesh dhe i diferenconte në trajtimin që shteti u bënte, në raport me kategori të tjera të shtetasve, në lidhje me strehimin, të



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

realizuar nëpërmjet një kontrate publike. Lidhur me këtë çështje, KShH bashkëpunoi me Avokatin e Popullit, duke dhënë sugjerimet e veta për mënyrat e ndërhyrjes për zgjidhjen e çështjes. Në dt.10.09.2012, Avokati i Popullit i drejtohet me një letër Kuvendit të RSH duke u shprehur se, Akti Normativ i Këshillit të Ministrave nr.3, datë 1.08.2012, është në papajtueshmëri me Kushtetutën, pasi Gjykata Kushtetuese ishte shprehur dy herë në favor të ankuesve dhe se afati i përcaktuar në aktin normativ për lirimin e banesave nga ankuesit (brenda muajit) dhe mjetet e parashikuara për strehimin e mëpasshëm të tyre (kredi e pjeshme bankare), ishin përcaktuar pa studiuar paraprakisht kushtet konkrete të këtyre shtetasve. Pavarësisht këtij reagimi, Kuvendi i RSH miratoi aktin normativ të sipërcituar, me anë të ligjit nr.82/2012 në dt.13.09.2012. Ndërkohë, Shoqata e Qerramarësve paraqiti një kërkesë të re në Gjykatën Kushtetuese, duke kërkuar shfuqizimin e ligjit në fjalë, por ajo Gjykatë e rrëzoi kërkesën e shoqatës. Aktualisht ata i janë drejtuar Gjykatës së Strasburgut dhe janë në pritje të shqyrtimit të ankesës së tyre. Lidhur me këtë çështje, KShH vëren se gjatë hartimit të këtyre akteve ligjore pati një mungesë të plotë të transparencës dhe të konsultimit me grupet përkatëse të interesit dhe se këto akte u miratuan pa njohur më parë situatën dhe kushtet konkrete të shtetasve që do të prekeshin prej zbatimit të tyre. Janë disa mijëra shtetasit që cënohen nga ky akt normativ, një pjesë e të cilëve janë në pamundësi objektive për të siguruar strehimin e ri duke marrë kredi nga bankat, siç parashikon ligji, për mungesë kolaterali dhe të të ardhurave të mjaftueshme, që do të garantonin shlyerjen e kredisë.

Një tjetër rast është ai i ankesave të bëra publikisht se në mjaft rrethe të vendit, sidomos në fshatra, po kryeshin ndërprerje të vazhdueshme të energjisë elektrike, me afate kohe të zgjatur, pavarësisht se ishin paguar rregullisht faturat. Në dt.7 Nëntor 2012, për këtë qëllim, kryem një vëzhgim në Qarkun e Lezhës. Gjatë këtij misioni, KShH morri takim me banorë të Komunës Kolsh dhe Zejmen, me drejtues të organeve të qeverisjes vendore dhe prefektin e qarkut. Nga ky monitorim rezultoi se ndërprerjet ishin kryer realisht, në mënyrë masive, duke përfshirë edhe banorët që kishin shlyer rregullisht detyrimin e pagesës së konsumit të kryer. Për shkak të situatës problematike, KShH reagoi në dt.8 Nëntor 2012 me një deklaratë për shtyp, duke u sugjeruar organeve përkatëse shtetërore që të ndërhyjnë urgjentisht për të stabilizuar gjendjen që po përkeqësohej çdo ditë e më tepër, në kushtet e dimrit të ftohtë. Ndërkohë iu sugjerua organeve të ndjekjes penale që me nismën e tyre, të fillonin çështjen penale ndaj atyre që kishin vepruar në kundërshtim me ligjin dhe kontratën e furnizimit me energji elektrike, duke cënuar rëndë interesat e ligjshme të shtetasve.

KShH ka përkrahur të gjitha nismat politike për realizimin e decentralizimit të pushtetit shtetëror. Zbatimi i këtij procesi, siç pritej, ngarkoi pushtetin vendor me më shumë përgjegjësi në ofrimin e shërbimeve bazë për shtetasit shqiptarë. Me qëllim vëzhgimin e respektimit të këtyre të drejtave nga organet e qeverisjes vendore, gjatë periudhës Tetor – Nëntor 2012, KSHH kreu disa monitorime në Bashkitë e Shkodrës, Kukësit, Elbasanit, Korçës, Fierit, Vlorës dhe Gjirokastrës. Në këto monitorime u angazhuan korrespondentet e përhershëm të organizatës në rrethe, të cilët vëzhguan aspekte të tilla si: numrin e ankesave drejtuar bashkisë nga qytetaret dhe natyra e tyre; mënyrën e zgjidhjes së ankesave dhe mënyra e komunikimit me shtetasit ankues; takimet e qytetarëve me Kryetarin e Bashkisë ose Komunës; respektimi i ditëve dhe orëve të takimit; zhvillimi i mbledhjeve të këshillave bashkiake dhe aksesit i publikut në to; si dhe probleme lidhur me ecurinë e procesit të decentralizimit, fondet që shoqëronin këtë proces etj.

U konstatua se shtetasit kishin drejtuar një numër të lartë kërkesash dhe ankesash në Bashkitë e Elbasanit, Korçës, Fierit dhe Vlorës. Bashkia e Kukësit kishte një numër më të vogël



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

kërkesë/ankesash. Bashkia e Gjirokastrës vuri në dispozicion të dhëna të pjesshme, ndërkohë që Bashkia e Shkodrës nuk dha asnjë statistikë. Për sa i takon mënyrës së pritjes së qytetarëve dhe marrjes së ankesave të tyre, në shumicën e bashkive ishin ndërtuar sisteme të ndryshme pune dhe vetëm në Bashkinë e Shkodrës mungonte ambienti për pritjen dhe informimin e qytetarëve. Për sa i takon mbledhjeve të këshllit bashkiak u konstatua se interesi dhe niveli i pjesëmarrjes së qytetarëve në këto mbledhje është ende shumë i ulët. Procesi i decentralizimit në këto bashki vazhdonte, por punonjësit e tyre ankohen se ky proces nuk është shoqëruar me transferimin e buxheteve të mjaftueshëm, sigurimin e burimeve të nevojshme njerëzore, dhe ngritjen e kapaciteteve të tyre. Gjithashtu bashkitë e monitoruara kërkojnë që në kuadër të decentralizimit të rriten më tej përgjegjësitë dhe kompetencat e tyre, me qëllim përmbushjen e nevojave dhe interesave të komunitetit lokal. Stafet e bashkive dhe qytetarët adresuan edhe çështje të tjera problematike që shqetësonin komunitetin lokal në këto bashki.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

ANEKSI I

TË DHËNA STATISTIKORE PËR SHËRBIMET LIGJORE TË OFRUARA

(JANAR – DHJETOR 2012)

1.1 Të dhënat e ankesave sipas kategorisë/nënkategorisë

Kategoria e ankesave	Nënkategoria	Numri i ankesave
<i>Burg/Paraburgim</i>	Dhunë (Fizike apo psikologjike) e ushtruar në burg nga personeli /të dënuar të tjerë	12
	Kushte të këqija në burgje dhe vendet e paraburgimit	7
	Mosdhënie e shërbimit shëndetësor dhe kujdesit social ne burg	21
	Mungesë informacioni nga administrata e brugjeve për amnistinë /faljen	3
	Puna e të burgosurve	1
	Shkelja e të drejtave në paraburgim /burgje	48
	Të tjera	2
	Transferim/mostransferim në një institucion tjetër/brenda të njëjtit institucion	9
Total Burgje/Paraburgim		103
<i>Civile të ndryshme</i>	Ankesa në lidhje me konfliktet e pronësisë	16
	Ankesa për shkeljen e të drejtës së informimit	2
	Ankesë për procedurat jo transparente nga organet e administrates qendrore dhe vendore	18
	Kërkesa për ndihme ekonomike/pensionet	3
	Të tjera	12
Total Civile te Ndryshme		51
<i>Gjyqësori</i>	Mosshqyrtim I masave mjekësore brenda afatit	1
	Mungesë e dhënies së informacionit nga Gjykatat	3



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

	Proces i parregullt ligjor	7
	Tejkalimi I afateve per paraburgimin	1
	Vendime të padrejta gjyqësore/prendim për pafajësi	17
	Zvarritje e procesit gjyqësor	1
Total Gjyqësori		30
<i>Marrëdhëniet e punës</i>	Ankesë lidhur me diskriminimin në punë	2
	Ankesë për lëvizje të padrejtë nga puna	2
Total Marrëdhëniet e Punës		4
<i>Policia</i>	Ankesa për ushtrim dhunë fizike/psikike nga organet e policisë	10
	Te tjera	4
	Veprime të padrejta nga organet e policise	3
Total Policia		17
<i>Prokuroria</i>	Shkelje Procedurale të procesit të hetimit	1
	Veprime të padrejta dhe arbitrare nga Prokuroria	8
Total Prokuroria		9
<i>Shërbimi Avokator</i>	Ankesa për shërbimin avokator kryesisht/të zgjedhur	2
	Asistencë për plotësim dokumentacioni	3
	Kërkesa për shërbim avokator falas (perfaqesim ne gjykate)	10
	Këshillim ligjor falas	36
Total Shërbimi Avokator		51
<i>Të tjera (Sistemi i drejtësisë)</i>	Ankesa për mosekzekutimin e vendimit gjyqësor nga Zyra e Përmbartimit	4
	Kerkese per demshperblim per burgim te padrejte	1
Total Të tjera (Sistemi i drejtësisë)		5
Total		270



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

1.2 Të dhënat e ankesave sipas qytetit/institucionit

Qyteti	BURG	GJENDJE E LIR	KOMISA RIAT	PARABURG IM	TJETE R	Tota l
BERAT	0	3	0	0	0	3
DURRES	0	4	0	1	0	5
ELBASAN	0	2	0	0	0	2
FIER	0	2	0	0	0	2
FUSHE- KRUJE	15	0	0	0	0	15
GJIROKASTE R	0	11	0	0	0	11
KAVAJE	5	2	0	0	0	7
KORCE	6	4	0	0	0	10
KRUJE	22	2	0	0	0	24
LAC	0	1	0	0	0	1
LEZHE	45	0	1	6	0	52
LIBRAZHD	0	1	0	0	0	1
LUSHNJE	4	0	0	0	0	4
PEQIN	13	0	0	0	0	13
POGRADEC	0	1	0	0	0	1
PUKE	0	1	0	0	0	1
RROGOZHIN E	9	0	0	0	0	9
SHKODER	1	18	0	0	0	19
TEPELENE	1	0	0	0	0	1
TIRANE	21	43	2	3	2	71
TJETER	0	4	0	0	1	5
VLORE	3	4	0	6	0	13



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Total	145	103	3	16	3	270
--------------	------------	------------	----------	-----------	----------	------------

1.3 Të dhëna sipas të drejtave të shkelura

Të drejtat e Shkelura	Total
E drejta e informimit	7
Ndalimi i Diskriminimit	9
Ndalimi i Torturës, Trajtimit C'njerëzor dhe Degradues	55
E drejta për liri dhe siguri	4
E drejta për një proces të rregullt	27
E drejta e pronësisë	9
Te tjera	159
Total	270

1.4 Të dhëna sipas shërbimeve ligjore të ofruara

Shërbimet Ligjore të Ofruara	Total
Asistencë ligjore për Plotësimin e dokumentacionit	10
Keshillim Ligjor	179
Monitorim Procesi Gjyqësor	13
Nderhyrje në Institucionet Shtetërore	202
Perfaqesim ne Gjykate	6
Reagime publike (Deklarata)	14
Trajtim ankese	403



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT
ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Verifikim	180
Total	1,007



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

ANEKSI II

TË DHËNA STATISTIKORE PËR MISIONET SPORADIKE TË MONITORIMIT

(JANAR – DHJETOR 2012)

2.1. BURGJE

Nr.Rendor	Institucioni I Ekzekutimit të Vendimeve Penale	Data e monitorimit
1	Institucioni për të Miturit, Kavajë	8 mars 2012
2	IEVP Vaqarr	9 Prill 2012
3	IEVP Vlorë	16 Prill 2012
4	IEVP Fushë - Krujë	7 Maj 2012
5	IEVP Shën Koll	8 Maj 2012
6	IEVP Fushë - Krujë	9 Maj 2012
7	Institucioni i Veçantë i Krujës	10 Maj 2012
8	Institucioni i Veçantë i Krujës	25 Maj 2012
9	Institucioni i Veçantë i Krujës	11 Qershor 2012
10	IEVP Rrogozhinë	15 Qershor 2012
11	IEVP Vaqarr	26 Qershor 2012
12	IEVP Shën Koll	11 Korrik 2012
13	IEVP Peqin	12 Korrik 2012
14	Qendra Spitalore e Burgjeve	17 Korrik 2012
15	IEVP Durrës	26 Korrik 2012
16	IEVP Korçë	3 Shtator 2012
17	IEVP Shën Koll	22 Nëntor 2012
18	IEVP Fushë - Krujë	

2.2 KOMISARIATE POLICIE

Nr.Rendor	Komisariati i Policisë	Data e monitorimit
1	Drejtoria e Policisë së Qarkut Vlorë	16 Prill 2012
2	Komisariati i Policisë nr.6 Tiranë	7 Shtator 2012



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

3	Komisariati i Policisë nr.1, Tiranë	9 Tetor 2012
4	Komisariati i Policisë nr.1, Tiranë	19 Tetor 2012
5	Komisariati i Policisë nr.2, Tiranë	26 Nëntor 2012
6	Komisariati i Policisë nr.3, Tiranë	7 Dhjetor 2012

2.3 MISIONE SPORADIKE NË FUSHA TË TJERA

Nr.Rendor	Objekti i Monitorimit	Data e monitorimit
1	Verifikim për grabitjet me armë në fshatin Luz i Madh (Kavajë)	18 Janar 2012
2	Verifikim për prishjen e barakave të disa familjeve Rome në Liqenin Artificial (Tiranë)	25 Janar 2012
3	Verifikim për grevën e urisë së 6 ish – naftëtarë të ndërmarrjes Gorisht – Kocul (Vlorë)	27 Janar 2012
4	Verifikim për prishjen e barakave të disa familjeve Rome në Liqenin Artificial (Tiranë)	31 Janar 2012
5	Verifikim për kushtet e jetesës së familjeve rome të vendosura pranë lumit Drino, Gjirokastër	14 dhe 18 Pril 2012
6	Verifikim për kushtet e jetesës së familjeve rome pranë liqenit artificial (Tiranë)	4 Maj 2012
7	Verifikim për pensionet e parakohshme të ish ushtarakëve në Institutin e Sigurimeve Shoqërore	7 Qershor 2012
8	Verifikim për vonesat e pagesave të kompensimit ndaj familjeve të përmytura në Komunitat Bushat, Trush, dhe Bërdicë (Shkodër)	28 Qershor 2012
9	Verifikim për grevën e urisë së ish të përndjekurve politikë (Tiranë)	9 Tetor 2012
10	Verifikim për ndërprerjet kolektive të energjisë elektrike në Komunitat Kolsh dhe Zejmen (Lezhë)	7 Nëntor 2012



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

2.4 MONITORIME SPORADIKE NË GJYKATË

Gjykata e Rrethit Gjyqesor	Gjykata e Apelit Tiranë	Gjykata e Lartë
1. Çështje penale kunder gazetares se medias se shkruar (16.04.2012)	1. Çështje civile lidhur me punen e te burgosurve (20.07.2012)	1. Çështje Penale (Durdaj k.Mediut) (17.09.2012)
2. Çështje e 21 Janarit, Penale (04.06.2012)	2. Çështje penale, kundërshtim vlefesimi mase sigurimi (09.11.2012)	2. Çështje Penale (Durdaj k.Mediut) (05.10.2012)
3. Çështja e 21 Janarit, Penale (20.06.2012)		3. Çështje civile pronesie (15.11.2012)
4. Çështja e ish punonjseve se Bashkise Tirane, Penale (03.07.2012)		4. Çështje Penale (Durdaj k.Mediut) (19.11.2012)
5. Çështja e 21 Janarit, Penale (19.09.2012)		5. Çështje Penale (Durdaj k.Mediut) (23.11.2012)
6. Çështje e 21 Janarit, Penale (26.09.2012)		6. Çështje Penale (Durdaj k.Mediut) (10.12.2012)
7. Çështje e ish punonjseve te Bashkise Tirane, Penale (18.10.2012)		
8. Çështje e ish punonjseve te Bashkise Tirane, Penale (01.11.2012)		
9. Çështje e ish punonjseve te Bashkise Tirane, Penale (14.11.2012)		
10. Çështje e 21 Janarit, Penale (14.11.2012)		
11. Çështja e 21 Janarit, Penale (21.11.2012)		
12. Çështja e 21 Janarit, Penale (05.12.2012)		
13. Çështja e 21 Janarit, Penale (10.12.2012)		



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT
ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

14. Çështja e 21 Janarit, Penale (26.12.2012)		
Totali i seancave te Monitoruara	26 seanca	



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

ANEKSI III

REAGIME PUBLIKE DHE NJOFTIME PËR SHTYP

(JANAR – DHJETOR 2012)

- 25 Janar 2012** *Njoftim pwr shtyp*
Veprime tw nxituara me pasoja tw dwmshme
- 1 Shkurt 2012** *Letwr e hapur lidhur me gjendjen e Romwve tw vendosur pranw Liqenit*
Artificial tw Tiranws
- 3 Shkurt 2012** *Deklarate*
Tw parandalohet cdo lloj diskriminimi ndaj minoritetit rom
- 3 Shkurt 2012** *Njoftim pwr shtyp*
Shqetwsim dhe pasiguri pwr qytetarwt pwr shkak tw kriminalitetit
- 17 Shkurt 2012** *Deklarat per shtyp*
- 15 Mars 2012** *Komiteti Shqiptar i Helsinkit kontribuon për fuqizimin e mbrojtësve të të drejtave të njeriut*
- 21 Mars 2012** *Masat organizative që ndërmarren nuk duhet të vështirësojnë jetën e pensionistëve*
- 2 Prill 2012** *Zbulimi i shpejtë i autorëve të veprave penale i shërben parandalimit të kimit dhe rrit besimin e publikut ndaj organeve të policisë*
- 19 Prill 2012** *Deklaratë për Shtyp - Presidenti konsensual është në të mirë të popullit dhe të zhvillimit demokratik të vendit*
- 21 Maj 2012** *Letër publike drejtuar anëtarëve të Kuvendit të Shqipërisë lidhur me zgjedhjen e Presidentit të Republikës*



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

-
- 6 Qershor 2012 *Tryezë Diskutimi lidhur me Reformën në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ)*
- 22 Qershor 2012 *Deklaratë për shtyp
Ngjarje me përmasa shqetësuese në Lazarat*
- 3 Korrik 2012 *Deklaratë për shtyp
Të zbatohet Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 842, datë 6 Dhjetor 2011*
- 6 Gusht 2012 *Më tepër kujdes dhe vëmendje për minoritetin rom*
- 7 Gusht 2012 *Një krim i rëndë dhe tepër barbar*
- 14 Gusht 2012 *Populli e ushtron Sovranitetin edhe drejtpërsëdrejti*
- 15 Gusht 2012 *Vrasje me pasoja të rënda që mund të parandalohej*
- 17 Gusht 2012 *Rasti i 'Nazmie Vishës' kërkon analizë të thellë dhe reflektim*
- 14 Shtator 2012 *Një akt i rëndë kriminal*
- 29 Shtator 2012 *Më tepër vëmendje ndaj të përndjekurve politikë*
- 8 Tetor 2012 *një akt i dhimbshëm tronditës për opinionin e gjërë shoqëror*
- 19 Tetor 2012 *Njoftim për shtypin dhe publikun dhe gjerë
Tubimi dhe organizimi të drejta themelore të shtetasve, dialogu mjete i duhur
për një shtet demokratik*
- 8 Nentor 2012 *Dënimet kolektive janë haptazi të paligjshme*
- 15 Nentor 2012 *Ultimatumi i CEZ kërkon përgjigje dhe ndërhyrje urgjente të Qeverisë*
- 7 Dhjetor 2012 *Shkelje flagrante e ligjit*